


# NAXHI KASORUHO

BIBLIOTEKA

85H-94

K 33

Muz: Selam M



## SELAM MAMANI

*Një jetë*

*me këngë*

albin

8517-94  
K33

NAXHI KASORUHO

SELAM MAMANI  
NJË JETË ME KËNGË



albin, 2002

NAXHI KASORUHO

SELAM MAMANI  
NJË JETË ME KËNGË

Redaktoi:  
Engjëliash Seriani

Korrektori:  
Parime Kasoraho

Kopertina:  
A. Alfred Mamani

© Autori.

ISBN: 99927-51-02-9

albin  
Tiranë, 2002

*Ja kushtoj:*

*Selam Mamanit*

*Kolegut, bashkëpunëtorit, mikut tim të paharruar, që për 40 vjet punoi me përkushtim e pasion, me fixarmonikë në krah, duke na lënë një krijimtari të begatë si një kontribut të vyer në zhvillimin e artit muzikor në Gjirokastrë e më gjerë.*

*Këtë libër ja kushtoj në shenjë respekti e mirënjohje të thellë.*

*Autori*

# PROLOGU

Në pranverën e vitit 1955 kur isha nxënës në klasën e shtatë të shkollës 7-vjeçare “Naim Frashëri”, në shtëpinë e kulturës të qytetit, që ishte vendosur në një godinë karakteristike në qendër të pazarit (shtëpia e Zigait) e që dominonte mbi të tjerat me kullën e sahatit në krye, organizohej një konkurs për fëmijët që dëshironin të vazhdonin mësimet për muzikë në Liceun Artistik “Jordan Misja” në Tiranë. Së bashku me fëmijë të tjerë ngjita shkallët e drunjta dhe në katin e sipërm të godinës hynë në një dhomë ku disa burra do të na provonin a kishim vesh për muzikë apo jo. Ishim të emocionuar dhe për herë të parë futeshim në këtë ambient. Midis anëtarëve të komisionit një djalë i ri, pak i shkurtër, i qeshur e me firzamonikë përpara na pyeti në dinim të këndonim ndonjë këngë, duke na çliruar kështu nga emocionet e duke na futur në botën e këngës që unë doja aq shumë e që dija të këndoja, bile shumë bukur, këngë që i mësonim në pallatin e pionierëve në korin që e drejtonte mësuesi ynë i dashur e i apasionuar, Thoma Kekezi. Në fund të provimit më përgëzuan për përgjigje të sakta dhe më uruan suksese para komisionit të Liceut Artistik në Tiranë.

I emocionuar e shumë i gëzuar i zbrita me furi shkallët e drunjta dhe fluturova për në shtëpi për t'i dhënë këtë lajm të gëzuar nënës time të dashur dhe të shtrenjtë. Në mendjen time u ngulit ai xhaxhi me firzamonikë, i cili qeshte e gëzohej sa herë që unë i riprodhoja saktë tingujt që ai nxirrte nga

firzamonika. E ky muzikant ishte Selam Mamani.

Në atë kohë nuk e imagjinoja se do të lidhesha kaqe shumë me të dhe qysh nga ai moment do të bëhesha bashkëpunëtor në të gjitha aktivitetet artistike që organizoheshin në qytet e që Selam Mamani do të ishte prezent në to. Për 40 vjet resht unë do të isha i pranishëm e afër aktivitetit artistik të Selam Mamanit. Kur ai do të drejtonte orkestrën e estradës profesioniste unë do të isha instrumentist, kur unë drejtoja një festival ai do t'i binte fizarmonikës, apo kur përgatitej një ansambël artistik në rang rrethi të dy do të bashkëpunonim e do të jepnim ndihmesën tonë në realizimin e tij, qoftë si autorë këngësh, po ashtu edhe si organizatorë të këtyre veprimtarive. Ndonëse ka disa vjet që është ndarë nga jeta e që humbja e tij ka brengosur familjen, shokët, të afërmit, kolegët e punës e amatorët e shumtë që e donin dhe e respektonin aq shumë Selam Mamani është i pranishëm në çdo bisedën tonë për problemet e artit e të kulturës. Veprimtaria e tij e gjatë e shumë produktive, humori e mardhëniet shumë të ngrohta me kolegët, e bëjnë atë prezent në aktivitetin tonë artistik me krijimtarinë, me eksperiencën e tij, nga ku ne i referohemi për të marrë shembull.

Selam Mamani i përket atij brezi muzikantësh që e filluan aktivitetin e tyre artistik në fillim të viteve 50-të. Ndonëse pa kryer studime në shkolla artistike ata me pasion e këmbëngulje në mënyrë autodidakte, përvetësuan deri në perfeksion artin muzikor duke u bërë drejtues kryesorë në lëvizjen muzikore të qyteteve ku punuan. Ata zhvilluan një lëvizje të gjerë amatore e, njëkohësisht, hapën rrugën për brezat e tjerë të muzikantëve që do të vinin të diplomuar në shkollat artistike e konservatorin shtetëror të Tiranës. Të tillë muzikantë kanë qënë: Themistokli Mone në Vlorë, Pavllo Sholla në Korçë, Asqeri Kadëna në Berat, Pjetër Dingu në Durrës, Mark Kaftalli në Shkodër,

vëllezërit Prodani e Kareco në Tiranë etj. me të cilët Selam Mamani kishte lidhje shumë të ngushta. Ai respektohej nga ata për talentin e tij e krijimtarinë e gjerë e të larmishme që kishte. Këtë respekt e vlerësim për krijimtarinë e Selamit nga kolegët e tij të qyteteve të tjera unë e kam ndjerë nga afër, jo vetëm në letër këmbime që kishin midis tyre, apo në shkëmbimin e krijimtarisë që ishte e shpeshtë dhe e vazhdueshme, por veçanërisht në takimet kombëtare të estradave profesioniste dhe ansambleve amatore, ku kjo miqësi shprehej shumë qartë e ku padyshim Selam Mamani ishte në epiqendër të bisedave me ta. I qeshur, me humorin e tij Selami i kthente në ditë të gëzuara këto takime midis miqsh e kolegësh, por edhe diskutonte e shfaqte mendime pozitive për krijimtarinë muzikore, lëvizjen amatore, për karakterin thellësisht kombëtar të artit tonë, popullore etj. duke i kthyer bisedat në kuvende për mbështetjen në muzikën nga ku çdo muzikant përfitonte e shkëmbente eksperiencën e tij të pasur.

I nisa këto shënime për të përjetuar veprën e denjë e të çmuar të njërit prej korifenjve të muzikës të qytetit tonë, Selam Mamani, që për 40-vjet nuk u shkëput nga skena as në momente të vështira e të dhimbshme.

Pikërisht përshtypjet, mbresat, kujtimet, vlerësimet dhe një jetë të gjatë pranë këtij muzikanti të talentuar e të mirënjohur të rrethit tonë e më gjerë, po i shpreh në këtë libër monografi kushtuar mikut, kolegut tim të paharruar Selam Mamani, të titulluar. "NJË JETË ME KËNGË"

Gjirokastër Prill 1999  
AUTORI

## GJIROKASTRA E VITEVE 30-40-të

### FËMIJËRIA

Qafa e Pazarit ishte qendra e gravitetit të qytetit nga ku nishin kalldrëmet e tejzgjatura për në lagjet e largëta si: Cfake, Manalat, Dunavat, Palorto, Varosh, Hazmurat, lagjia “Punëtore”, por ishte edhe si vend takimi i gjithë qytetarëve nga ku me njeri tjetrin nishin rrugën për në lagjet e tyre. Ishte ky një ritual shekullor i vendosur pa fermane e vula për një



*Amatorë të Pallatit të Kulturës në vitin 1955*



mirëkuptim në heshtje i gjithë banorëve të qytetit, të cilët mbas pune do të dilnin tek Qafa e Pazarit e, mbasi të gjenin ndonjë bashkëlagjas, bënin rrugën së bashku për në shtëpitë e tyre. Aty qëndronin postjerët e qytetit e prisnin me durim klientët e tyre për të mos u ngjitur deri në lagjet e sipërme të qytetit.

Ishte një jetë e vakët kjo në qytetin tonë pa zhvillime sociale e kulturore. Në atë kohë në qytet, rreth kodrës së obeliskut ishin krijuar disa shoqëri kulturore e patriotike që zhvillonin herë pas here ndonjë veprimtari shoqërore e artistike duke gjallëruar kështu disi jetën e vakët të qytetit.

Në këtë ambjent social e shoqëror lindi më 22 Dhjetor 1932, në lagjen "Palorto" muzikanti i ardhshëm i qytetit, Selam Mamani.

Fëmijëria e tij nuk kishte asgjë të veçantë nga ajo e shokëve e moshatarëve të tij. Mbasi mbaronin mësimet në shkollë vinin në shtëpi, merrnin një copë bukë me djathë dhe me vrap e tek sheshi i Zemanit, ku luanin me top lecke apo saiset, poçë fshehon, doken, virat etj., lojra të moshës që ishin në atë kohë. Çdo lagje kishte një shesh ku luanin e argëtoheshin fëmijët si në Cfakë ishte sheshi i Mejdanit, në Manalat, sheshi i Zinxhireve, në Dunavat sheshi i Poshit, në Palorto sheshi i Shtinos e sheshi i Kokonës, në Varosh lëmi i Zekate e të tjera vënde ku fëmijët kalonin pjesën më të madhe të kohës së tyre jashtë shtëpisë. Në këto lojëra me moshatarët, siç thotë vëllai i tij Hulusiu, Selami ishte fëmijë i qetë, i donte dhe e donin shokët, ishte shumë i pastërt, aq sa kur vinte në shtëpi nuk kishte nevojë të lahej e të pastrohej. Qysh në këtë moshë Selami ishte i apasionuar mbas muzikës. Ai kishte bërë një bori me lofatë (instrument shumë i përhapur në atë kohë në gjithë fëmijët e qytetit) që i binte gjatë ditës duke imituar melodi të ndryshme që ai dinte, gjë që tregonte dëshirën për muzikë si dhe talentin e tij. Aq shumë luante me borinë e tij sa që Aneja

(nëna e tij siç i thoshte) e qortonte duke i thënë: “pusho more lanet se na more mëndjen me atë borinë tënde”.

Aneja ishte ajo që e inkurajonte Selamin të merrej me muzikë. Ajo vetë këndonte shumë bukur këngët e folklorit të pasur Gjirokastrit sidomos këngët e grave, aq sa e ftonin edhe në dasma që të këndonte e gjallëronte atmosferën e festës. Aneja ishte vajzë nga fisi i Zverkut nga Cfaka. Vëllezërit e saj, Haxhi e Vait Zverku ishin këngëtar, të mirënjohur të këngës popullore Gjirokastrite dhe këndonin me grupet e qytetit edhe në Radio-Gjirokastra. Pikërisht këtë trashëgimi ajo donte ta trasmetonte edhe tek djali i madh, Selami.



*Selam Mamani dhe mbesa Flora, në një koncert*

Në këtë mënyrë monotone e kaloi fëmijërinë e tij Selam Mamani. Ishite 7-vjeç kur vendin e pushtoi Italia fashiste. Vitet e pushtimit fashist e nazist ishin të rënda për mbarë popullin shqiptar. Varfëria, skamja, fukarallëku ishin prezentë në të gjitha familjet gjirokastrite. Në këtë gjendje ishte përfshirë edhe jeta e fëmijëve. Mbas çlirimit të vendit jeta në mbarë vendin do të fillonte të ndryshonte në kahjen pozitive, ku mbarë populli u përfshi në një mobilizim total për të

rindërtuar vendin e shkatërruar nga lufta. Pikërisht në vitet e para të çlirimit Selam Mamani filloi të merrej me muzikë, e çdo mbas dite mbas punës, shkonte në shtëpinë e Kulturës ku mësonte fizarmonikën së bashku me moshatarët e tij Sokrat Kalivopulli, Qimo Papadhopulli, Aleko Pano, Aleko Kareco etj. muzikantë të rinj, të apasionuar mbas muzikës. -I mësonte këta të rinj me durim e pasion një fizarmonicist i përgatitur në atë kohë, Aleko Kareco duke dhënë kështu një ndihmesë konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të muzikës në qytetin tonë.

Në atë kohë në qytet ishte edhe një bandë muzikore që drejtohej nga një muzikant i pasionuar Koço Vangjeli. Koço Banda, siç e thërrisnin qytetarët e Gjirokastrës, punonte me pasion e durim me një grup të rinjsh që ishin të apasionuar pas muzikës. Ky formacion muzikor u krijua qysh në vitin 1931, dhe erdhi gjithmonë duke u konsoliduar e duke e rritur cilësinë artistike. Selam Mamani qysh në rininë e hershme u regjistrua në këtë bandë dhe filloi të mësojë instrumentin e Tenorit, por instrumenti që i pëlqentë më shumë ishte.

## “FIZARMONIKA”

Fizarmonika do të bëhej për Selam Mamanin instrumenti muzikor më i dashur dhe i pandarë për gjithë jetën. Për 50 vjet rresht ai do ta mbante atë në krahë duke treguar një vullnet e pasion të jashtëzakonshëm dhe duke e përvetësuar atë deri në perfeksion. Fizarmonika u bë sinonimi i Selamit dhe nuk mund ta përfytyroje atë pa fizarmonikë në krahë. Jo vetëm në rininë e hershme e më vonë, por deri në fund të jetës Selami nuk e

nda u fizarmonikën nga krahët. Me të në krahë ai u ngjit në skena e podiume, tek lëmi i fshatit e në takime kombëtare, në aksionet e rininë e kudo ku zhvilloheshin aktivitete artistike. Ai i kushtoi gjithë preokupimin e pasionin e tij fizarmonikës. Nuk u nda asnjë çast prej saj dhe luante me të me mjështëri e preokupacion gjithë repertorin që bënte orkestra. Si rezultat i përgatitjes së mirë që kishte në fizarmonikë, Selami në vitin 1949 u inkuadrua në Brigadat kulturore që organizoheshin në atë kohë e që shkuan në Veri të vendit për të gjallëruar jetën në përgjithësi në këto zona e për të përhapur kulturën, duke ndikuar në emancipimin e atyre zonave të thella.

Selami tregonte kujdes sidomos në mësimin e notave muzikore, të solfezhit, të cilin e përvetësoi mjaft mirë. N.q.s do të shohësh shkrimet muzikore të Selamit, ato janë mjaft të rregullta, të shkruara shumë bukur, me një kaligrafi që të gjithë ne muzikantët e kolegët e tij e kishim zili e i luteshim të na shkruante pastër edhe këngët e krijimet tona.

Shtëpia e kulturës ka qënë në disa godina gjatë viteve në qytet. Mbas çlirimit Shtëpia e Kulturës ishte vendosur në një godinë të vjetër që ndodhej tek vendi ku sot është ndërtuar hotel "Turizmi". Ndërsa në vitin 1947, tek shtëpia e Ciut që ndodhej tek kodrat e monumenti, ndërsa nga viti 1953, shtëpia e kulturës u vendos tek godina karakteristike e Zigait, në qëndër të pazarit.

Pallati i Kulturës një godinë shumë e bukur e funksionale, me skenë e sallë shfaqje, me ambjente të shumta për prova e aktivitete të ndryshme të lëvizjes amatore, u inagurua në vitin 1962 dhe ishte ndërtuar tek kodra e monumentit. Në vitin 1972 u inagurua godina e re e Kino Teatrit, ku u vendosën trupat profesioniste të Teatrit dhe Estradës, ndërsa lëvizja amatore i zhvillonte aktivitetet e saj në Pallatin e Kulturës.

Ishte kjo një panoramë e rritjes cilësore të ambienteve të Shtëpisë së Kulturës në qytet, nga godina të thjeshta në pallate kulture, që ndikuan ndjeshëm e pozitivisht në rritjen cilësore të veprimtarive të ndryshme kulturore e artistike. Në shtëpinë e kulturës së qytetit kishte shumë grupe të ndryshme artistike si, orkestrina popullore, orkestra, grupi i baletit, trupa e teatrit si dhe një grup koral shumë i mirë, që drejtohej nga muzikanti amator e i apasionuar Petraq Njocko. Kori kishte një aktivitet shumë të gjerë artistik; bashkë me korin, i cili ishte mbi 40 veta, qenë orkestra, grupi i oktetit, solistët etj. Këtë kor e shoqëronte një orkestër e vogël ku bënin pjesë Selam Mamani e Aleko Pano me fizarmonikë, Tolo Njocko me trombon, Hajro Kokona me trombë, Nasho Zhulla në violinë e Shori Kuvarati si dhe Polo Ndreu në xhez. Pranë korit ishin edhe solistët Xhina Papakosta, Rustem Asqeri, Maliq Çomo, Saide Qofte, Majnur Kadëna, Xhina Titani etj. Ndonëse amatorë, që nuk kishin bërë shkollë muzike, ata i karakterizonte të gjithë dëshira e pasioni për muzikën, prandaj shkonin pothuaj çdo ditë në provat e orkestrës e korit për të mësuar pjesë të reja e për të zgjeruar repertorin e tyre artistik.

Bënin pjesë në këtë kor mjaft të rinj të apasionuar mbas muzikës si: Apostol Ura, Arjana Çene, Drita Tushe, Gaqe Kekezi, Apostol Naçi, Vera Sako, Saide Qofte, Jorgo Qurku, Llaqi Dono, Jorgo Maliko, Petrit Avdalli, Skënder Mamani, Lejla Muço, Niqi Naka, Seno Kokona, Niko Lula, Saide Kallfa, Fazilet Kokona, Kaman Qezi, etj.

Këto formacione jepnin shpesh herë koncerte në lagjet e qytetit e në fshat me raste festash e në ditët e votimeve, duke gjallëruar jetën artistike të qytetit. Krahas korit, një formacion muzikor me aktivitet mjaft të gjerë, ka qenë dhe banda muzikore e qytetit. Mbas çlirimit bandën e drejtonte muzikanti i pasionuar

Tolo Njocko. Ai me përkushtim e shumë dashuri, duke i njohur mjaft mirë të gjitha veglat e bandës, vazhdoi të ruante traditën pozitive të këtij formacioni që gjallëronte jetën artistike të qytetit. Qysh nga krijimi i saj në vitin 1932 në bandë bënë pjesë muzikantë si: Mixha Hasho, Tolo Njocko, Vangjel Bashari, Emin Çapollari, Petraq Njocko, Muhedin Jaho, Alizot Emiri, Pertef Kallfa, Vaso Selica, Galo Mene, Mahir Karabina, Pano Koçollari, Hajro Kokona, Skënder Tushe, Kristo Mastakuli, Nako Muka, Çavo Kekezi, Resul Malile, Abaz Fule, Lavo Erindi, Këço Godella, Hiqmet Shtino, Sajo Kokalari, Fejzi Babaramo etj., një pjesë e mirë e të cilëve e vazhduan veprimtarinë e tyre në bandë deri në vitet 80-të.

Banda muzikore e qytetit gjatë 70-vjetëve të ekzistencës së saj është plotësuar me instrumentistë të rinj që kanë ardhur nga shkollat artistike si dhe nga lëvizja amatore e qytetit. Gjithashtu në atë kohë në Gjirokastër ishte ngritur dhe një rreth teatri që drejtohej nga Milto Hido, i apasionuar mbas teatrit dhe që i takon merita e ngritjes të teatrit amator, teatër i cili jepte shpesh në qytet e në fshat.

Të gjitha këto formacione artistike, që ishin ngritur mbi baza amatore, zhvillonin një veprimtari të gjerë duke e gjallëruar jetën në qytetin tonë. Në tërë këto vite të aktivitetit të tij Selam Mamani u bë epiqendra e çdo veprimtarie muzikore. Përvetësimi i shumë pjesëve, këngëve e valleve të ndryshme, duke krijuar një repertor të gjerë artistik, e bën atë të ndodhet prezent në tërë veprimtarinë artistike e kulturore që zhvilloheshin në qytetin tonë. Siç shprehet edhe Aleko Pano, një nga miqtë dhe bashkëpunëtorët e ngushtë të Selamit, një mësues i nderuar dhe muzikant me kontribut të shquar në zhvillimin e lëvizjes amatore se: Selami e zotëronte mjaft mirë fizarmonikën dhe luante në të të gjitha pjesët dhe repertorin e shumtë që kishte

formacioni i orkestrës që shoqëronte korin, solistët dhe baletin në shtëpinë e kulturës. Selami shquhej për një kujtesë mjaft të mirë muzikore. Ai i mësonte përmendësh të gjitha pjesët e programit dhe luante mjaft i sigurtë në fizarmonikë. Trup vogël, simpatik, shumë i rregullt, i qeshur dhe mjaft komunikues. Ai i bënte për vete spektatorin dhe inkurajonte këngëtarët në skenë duke i çliruar nga emocionet.

Ndonëse erdhën në Gjirokastër mjaft muzikantë nga shkollat e muzikës që i binin fizarmonikës, përsëri Selam Mamani ngeli instrumentisti nr.1, i cili nuk ju nda fizarmonikës e skenës deri në fund të jetës së tij. Është ky një tregues mjaft i qartë prej nga dalin në pah vlerat muzikore, interpretative, krijimtaria dhe aktiviteti artistik i të pahuarit Selam Mamani.

Le të kthehemi edhe një herë në fundin e viteve 40-të, ku një ndihmesë në zhvillimin e lëvizjes amatore kanë dhënë edhe muzikantë të ndryshëm që kishin ardhur në Gjirokastër si muzikologu, kompozitori e violinisti Mexhit Daiu, i cili bashkëpunonte dhe çmonte talentin e Selami Kishin ardhur për të kryer shërbimin ushtarak në Gjirokastër dhe disa muzikantë të talentuar nga Shkodra si Tonin Harapi, Zef Leka e Preg Gjeloshi të cilët ndikuan pozitivisht në rritjen profesionale të aftësive muzikore të Selamit, por që gjallëruan edhe jetën artistike të qytetit. Tonin Harapi një muzikant mjaft i talentuar, që më vonë u bë një personalitet në kulturën tonë kombëtare, në fillim të viteve 50-të kompozoi një operetë për fëmijë të titulluar "Mësimi i pyllit" që u shfaq me shumë sukses e u pëlqye nga fëmijët por edhe nga spektatori Gjirokastrit. Duke bashkëpunuar për shumë kohë me këta muzikantë, Selami filloi të perfeksionojë mjaft mirë fizarmonikën, teorinë e solfexhit si dhe kompozimin e këngëve dhe orkestracionin e tyre. Si rezultat i përgatitjes të mirë që kishte në fizarmonikë,

shkoi për të kryer shërbimin ushtarak në Tiranë ku gjatë kësaj kohe bënte pjesë në fanfarën ushtarake pranë Asambllit të Ushtrisë. Kjo e ndihmoi atë të aftësohej si muzikant dhe e përgatiti për të qënë një nga themeluesit e orkestrës së estradës profesioniste të qytetit. Ky realitet artistik, me veprimtari të shumta që zhvillonte shtëpia e kulturës, u bë baza dhe përgatitën terrenin si dhe hapën perspektivën për të krijuar në Gjirokastrë një trupë artistike profesioniste.

## ESTRADA PROFESIONISTE TRUPA ARTISTIKE QË DHA KONTRIBUT NË GJALLËRIMIN E JETËS ARTISTIKE TË QYTETIT

Në Dhjetor të vitit 1955, me vendim të qeverisë, u krijua Estrada Profesioniste e qytetit. Më në fund kontributi i gjithë amatorëve të shtëpisë së kulturës u kurorëzua me sukses duke krijuar një trupë artistike profesioniste me katërmbëdhjetë veta, nga të cilët 6 aktorë, 3 muzikantë, 2 këngëtarë, 2 valltarë dhe një regjisor. Fillon kështu një etapë e re me lëvizjen artistike të qytetit, jo vetëm në vazhdimësinë e pandërprerë të aktiviteteve në qytet dhe në fshat, por tashmë do të punohej mbi baza profesionale për të rritur së tepërmi nivelin artistik të çdo shfaqje. Selami së bashku me Tolo Njockon e Thodhori Kuvaratin do të përbënin bërthamën e orkestrës së estradës, e cila do të plotësohej me mjaft amatorë si Aleko Pano, Hajro Kokona, Nasho Zhulla, Polo Xhorri, Niko Naka, Naxhi





*Muzikantë dhe aktorë të estradës profesioniste në vitin 1958*




*Muzikantë dhe aktorë të estradës profesioniste në vitin 1958*

Kasoraho, Vaso Buka, Vaso Naka etj., të cilët do të përballonin mjaft mirë të gjithë repertorin muzikor që luhej në atë kohë. Selami do të ishte dirigjenti i parë i kasëj orkestre. Krijimi i estradës profesioniste erdhi si rezultat i një pune shumë të mirë që kishte bërë përpara aktori i Teatrit Popullor Prokop Mima, i cili në rolin e regjisorit do të punonte për 2 vjet në qytetin tonë. Selami, si drejtues i këtij formacioni muzikor, do të interesohej si për repertorin muzikor, por edhe për ngritjen e nivelit profesional të të gjithë instrumentistëve. Ai qysh në orën 8 që fillonte puna e deri në përfundim të saj nuk hiqte fizarmonikën nga krahët. Herë studjonte pjesë e ushtrime për fizarmonikë e herë pjesë të ndryshme që kishte repertori muzikor i estradës. Në atë kohë estradat pothuaj në gjithë vendin (ishin krijuar disa të tilla programin, e ndërtonin në një platformë pothuaj klishe: këngë-skeç-parodi. Kjo bënte që gjysma e programit të ishte material muzikor dhe gjysma tjetër material letrar si skeçe, monologje etj. Pikërisht në këtë kohë Selami u njoh me drejtuesit e muzikës në qytete të ndryshme të vendit, ku nëpërmjet një letër këmbimi të dëndur komunikonte me ta dhe shkëmbenin krijimtarinë e tyre.

Kompozitori i mirënjohur Agim Prodani, autor i qindra këngëve, në atë kohë mjaft të njohura e të pëlqyera nga publiku i gjerë nëpërmjet transmetimit në Radio Tirana, do të ishte bashkëpunëtori më i afërt i Selamit dhe do të dërgonte për estradën e Gjirokastrës një repertor mjaft të gjerë si këngë-kuplete-parodi, bile edhe hyrjen e shfaqjes që në atë kohë e quanin marsh apo aperturë. Ky bashkëpunim vazhdoi për një kohë mjaft të gjatë. Këngët e Agim Prodanit, që në atë kohë ishin mjaft të bukura e pëlqeheshin nga spektatorët, përbënin repertorin kryesor të solistëve të estradës. Përveç këngëve që dërgonin autorë të ndryshëm nga rrethet, në repertorin e estradës

profesioniste filluan të zënë vend edhe krijimet e Selam Mamanit e të Tolo Njockos. Tolu ishte dirigjenti i bandës së qytetit dhe zhvillonte me të një aktivitetet mjaft të dendur koncertal. Në atë kohë në Sheshin e Çerçizit, (te vendi midis bustit të dy heroinave dhe rrapit historik), ishte ngritur një podium i rumbullakët me çimento dhe i rrethuar me parmakë druri, ku banda e qytetit çdo të dielë jepte koncerte. Ishte ky një ritual mjaft interesant dhe ndiqej me shumë ineres nga qytetarë të shumtë që mbushnin Sheshin e Çerçizit.

Në atë kohë të shtunën dhe të dielën në mbrëmje, duke filluar nga sheshi e deri tek kthesa mbi shkollën “Pedagogjike”, bëhej një shëtitje masive e banorëve të qytetit duke ngjitur e zbritur disa herë, deri sa në mbrëmje vonë shpërndareshin në shtëpitë e tyre, një ritual ky që zhvillohej pothuaj në gjithë qytetet e Shqipërisë. E gjallëronte këtë atmosferë koncerti i bandës muzikore që drejtohej nga Tolo Njocko. Repertori i koncertit ishte mjaft i lamirshëm dhe në të bënë pjesë vepra



*Këngëtari Maliq Çomo dhe Orkestra e Estradës në vitin 1960*

të dëgjua të literaturës klasike botërore. Ndonëse në këtë formacion bënin pjesë muzikantë amatorë, niveli i ekzekutimit ishte mjaft i mirë dhe krijonte emocione tek dëgjuesit.

Në vitin 1957 kam marrë pjesë edhe unë në bandën e qytetit ku luaja me klarinetë. Në atë kohë isha nxënës në Liceun artistik "Jordan Misja" në Tiranë dhe Tolua më mori në formacionin e bandës, ku luaja me klarinetë, së bashku me Sajo Kokalarin. Krahas pjesëve të njohura klasike si "vals i Danubit", marshe-



*Violinisti i mirënjohur Vasil Mastora në një koncert i shoqëruar nga Selam Mamani*

polka, pjesë nga operat e huaja, luanim edhe një pjesë që titullohej "Ushtari i humbur" që tani nuk më kujtohet autori i saj. Kur luanim këtë pjesë Hajro Kokona, që i binte shumë bukur trompës, largohej nga podiumi dhe shkonte tek pemët që ishin në vendin midis Bashkisë e hotel Turizmit sot. Kjo pjesë kishte një përmbajtje të tillë: banda, që mendohej si një formacion ushtarak, kërkonte një shokun e tyre ushtar që kishte

humbur. Mbasi luhej nga banda pjesa në disa momente përgjigjej “ushtari i humbur”, që në këtë rast e imitonte Hajro Kokona me trompën e tij. Ky dialog midis bandës e “Ushtarit të humbur” ishte mjaft interesant dhe të gjithë dëgjonjësit që ndodheshin në shesh kthenin kokën nga vendi që vinte tingulli i trompës. Në atë kohë unë isha mjaft i ri dhe më bënte përshtypje kjo mënyrë ekzekutimi në distancë dhe, sa herë që dilnim në shesh, i lutesha Tolos që ta luanim këtë pjesë.

Koncertet e bandës dhe shfaqet e estradës profesioniste ishin aktivitetet artistike që gjallëronin jetën kulturore të qytetit. Me krijimin e estradës profesioniste tani në qytet kishte dy institucione artistike: Shtëpia e Kulturës me organikë shefin e muzikës, regjisorin, piktorin, magazinierin, masovikun, koreografin si dhe estradën profesioniste me 14 veta, por që ishin inkuadruar në një drejtori. Përveç shfaqjeve që jepte estrada profesioniste kishte dhe një aktivitet të dëndur edhe nga amatorët e shtëpisë së kulturës si p.sh. nga kori, grupi i valleve, solistët, orkestrina popullore, banda etj. Me solistët e estradës, që në kalimin e viteve ishin Rustem Asqeri, Xhina Papakosta, Xhina Titani, Maliq Çomo, Majnur Kadëna, Koço Papanastasi etj., Selam Mamani ndërtoi një grup muzikor që shoqërohej nga një orkestër e vogël e që jepte koncerte në fshatra, qendra pune. Çdo të premte në orën 18.30, ky formacion shfaqte një program prej 30-min. direkt në Radio Gjirokastra e që pëlqehet shumë nga dëgjuesit. Në këtë formacion orkestral bënin pjesë Selam Mamani, Aleko Pano, Polo Xhori, Hajro Kokona, Tolo Njocko, Naxhi Kasoruh, Niko Naka, Vaso Naka, Polo Ndreu etj., të cilët me pasion e dashuri shoqëronin të gjitha këngët që këndonin solistët e lart përmendur. Selami punonte gjatë gjithë javës për të përgatitur këtë program. Unë kam pasur rastin të jem për shumë vite pjesëtar i kësaj orkestre dhe e kujtoj me

respekt e nostalgji atë kohë dhe punën mjaft pasionante që bënëin të gjithë këngëtarët e orkestrantët nën drejtimin e Selam Mamanit.

Përveç këtyre muzikantëve, në estradën profesioniste në vitet e para të krijimit të saj kanë punuar edhe muzikantët popullorë Vasil Mastora e Demir Sulejmani. Selami kishte mardhënie mjaft të mira me ta dhe i shoqëronte me fizarmonikë në pjesët solo që ata bënëin me violinë e klarinetë. Vasili, Demiri dhe gjithë muzikantët popullorë e donin dhe e respektonin shumë Selamin. Ata gjenin tek ai mbështetësin kryesor për gjithë aktivitetin e tyre që bënëin në Pallatin e Kulturës, ku Selami ka qënë shëf i muzikës për shumë vite.

Duke qënë korrekt në jetën private, në punë e në skenë, Selami gjithmonë ishte kërkues dhe këmbëngulte për çdo këngë e material muzikor të përgatitej sa më mirë e me nivel artistik. Me kalimin e viteve formacioni i orkestrës së estradës erdhi duke e rritur nivelin profesional dhe, herë mbas here, ndronte edhe përbërja e saj me instrumentistë të ndryshëm në vartësi të muzikantëve që kishte në atë kohë në qytet. Në fillim të viteve 60-të në orkestrën e estradës punoi me klarinetë dhe me saks muzikanti i mirënjohur Jorgo Roze. Për shumë vite Jorgua do të mirrte drejtimin e orkestrës së estradës profesioniste dhe do të bëhej një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë e më të dashur me Selam Mamanin. Aftësitë profesionale, talenti dhe dëshira që kishte Jorgua për muzikën, e bënë atë një figurë të njohur në lëvizjen muzikore të qytetit të Gjirokastrës e më gjerë. Me aftësi të mëdha interpretative në klarinetë ai u bë i njohur në mbarë vendin me ekzekutimet e tij dhe formacionin e orkestrës së estradës në takimet e ndryshme kombëtare, ku estrada profesioniste e Gjirokastrës gjithmonë nderohej e vlerësohej për nivel artistik. Në atë kohë punuan në estradën e Gjirokastrës

dhe Rudak Ismaili, një fizarmoniçist mjaft i talentuar, i cili erdhi nga Përmeti këngëtarja e re Arta Babaramo që u bë mjaft e njohur kur shkoi në Tiranë si soliste në estradën e Ushtarit. Të gjithë këta instrumentistë të rinj e të talentuar ndikuan pozitivisht në nivelin artistik të muzikës në estradën profesioniste



*Instrumentistët Polo Xhori, Roland Çene, Selam Mamani e Niko Naka në një koncert në vitin 1961*

të qytetit tonë.

Në shtator të vitit 1966, mbasi mbarova studimet për muzikë në Konservatorin shtetëror të Tiranës, fillova punë në orkestrën e estradës profesioniste të Gjirokastrës, fillimisht si klarinetist dhe më vonë si dirigjent i saj. Së bashku me mua erdhi në Gjirokastrë dhe muzikanti mirënjohur, Artisti i Merituar, Gjon Simoni, i cili u caktua shef i muzikës në Pallatin e Kulturës. Me Gjonin Selami u lidh në një miqësi të ngushtë e të pandarë. Gjoni ishte jabanxhi, siç i themi ne në Gjirokastrë, pra i vetëm dhe banonte tek një dhomë e vogël në qendër të pazarit. Selami e ndihmonte për çdo gjë që mund të kishte Gjoni dhe të dy e donin dhe e respektonin shumë njeri tjetrin. Gjon Simoni ishte



*Kolektivi i Estradës Profesioniste në vitet e para të krijimit*

një muzikant mjaft i talentuar dhe me kulturë të gjerë muzikore, ai kishte mbaruar Konservatorin Shtetëror të Tiranës në degën e teorikës me rezultate të larta. Unë e kisha shok klase në konservator Gjonin dhe erdhëm të dy në të njëjtën kohë në Gjirokastrë. Po, përveç mbështetjes e miqësisë që kisha me Gjonin, ai gjeti edhe një mik e koleg shumë të mirë edhe tek Selami. Duke e ndjerë e parë nivelin e lartë profesional të Gjonit, Selam Mamani u mundua të përfitonte sa më shumë nga këto vlera si në drejtimin teorik, harmoninë, orkestracionin e kompozicionin, të cilat e ndihmuan më vonë Selamin për veprimtarinë e tij mjaft produktive me vlerë artistike në fushën e muzikës. Gjatë 2 vjetëve që qëndroi Gjoni në Gjirokastrë, Selami i rrinte gjithmonë pranë dhe ajo kohë ishte për të një shkollë profesionale nga ku përfitoi shumë dhe rriti në mënyrë



të ndjeshme nivelin e tij artistik. Do të shtoj edhe një vlerë e kontribut që dha Gjon Simoni në Gjirokastër: në vitin 1968 ai formoi një orkestër me instrumenta popullore të temperuar si fyej, longarë, jare, bilbil, llahutë, llahutë bas etj., të cilat i punoi me shumë pasion e profesionalizëm të lartë shkencor, duke u konsultuar për problemet të akustikës e të fuzionit me pedagogun e mirënjohur të Gjinnazit "Asim Zeneli" z. Luiz Çene dhe që i punuan në torno me mjeshtëri Teli Stefani e Vaso Naka. Ky formacion orkestral mori vlerësimet më maksimale nga elita e muzikës Shqiptare si Çesk Zadeja, Tonin Arapi, Albert Papanisto, Tish Daia e të gjithë muzikantët që ndodheshin në vitin 1969 në Vlorë, ku u ekspozuan në takimin e ansambleve artistike disa numra me këtë formacion dhe që ngjallën shumë ineres, duke u vlerësuar si pjesët më prestigjioze të këtij koncerti, dhënë nga ansambli i shtëpisë së kulturës, Gjirokastër. Në këtë takim, nën drejtimin e dirigjentit të mirënjohur Roland Çene, të sapo ardhur në atë kohë në Gjirokastër mbas mbarimit të studimeve në Insitutin e Lartë të Arteve, Grupi i Gjirokastrës meritoi flamurin. Është për të ardhur keq që ky formacion me shumë vlera, mbas disa viteve u abandonua dhe u la pas dore duke degraduar deri në eliminimin e tij nga pasardhësit e Gjonit.

Qysh në vitin 1961, shtëpia e kulturës dhe estrada profesionale u vendosën në godinën e re e mjaft të bukur e funksionale të pallatit të ri të kulturës,, që ishte ndërtuar tek kodra e monumentit. Në godinën e pallatit të kulturës ishte vendosur edhe biblioteka e qytetit. Aktiviteti muzikor me formacionin e orkestrës, ku bënë pjesë shumë këngëtarë e orkestrantë të ndryshëm e që i zhvillonin provat në pallatin e ri të kulturës, erdhi gjithmonë në rritje si në drejtim të veprimtarive muzikore në qytete e në fshat, por edhe në drejtim të rritjes cilësore të aktivitetit të tyre. Përveç këtij aktiviteti muzikor të pallatit të kulturës, një



*Selam Mamani duke bërë prova me kompleksin vokal të një ndërmarrje prodhimi.*

zhvillim të madh e të pandërprerë pati dhe kolektivi i estradës profesionale, e cila në atë kohë jepte mbi 120 shfaqje në ndërmarrjet ekonomike të qytetit, në fshatra të rrethit e në gjithë qytetet e jugut e deri në turnetë që bënte në mbarë vendin. Për të ekspozuar një repertor kaq të gjerë e të larmishëm si në tematikë ashtu edhe në përshtatje me auditorët ku jepej shfaqja, Selami interesohej që në këto programe përveç këngëve që merrte nga miqtë, shokët e kolegët e tij në rrethe të ndryshme, të siguronte edhe një repertor me këngë të huaja që i nxirte nga inçizimet e Radio Tiranës apo nga filmat që luheshin në kinemanë e qytetit. Në atë kohë filluan të zinin vend në repertorin muzikor të estradave tona shumë këngë Meksikane, Argjentinase, Spanjolle etj, të cilat publiku i pëlqente shumë e i duartrokiste ngrohtësisht. Rustem Asqeri e Maliq Çomo këndonin atë kohë me pasion e nivel artistik këngët: "Granada",

“Aire dum xhiki dum” etj, të cilat i rritnin vlerat repertorit muzikor të estradës tonë. Jo vetëm në Gjirokastrë por edhe në gjithë qytetet e vendit, të dy këta këngëtarë mjaft të mirë e me zë karakteristik e të shndritshëm, të veshur me veshje Meksikane e me sombrero në kokë, këndonin nën shoqërinë e orkestrës të drejtuar nga Sela Mamani këngët aq të bukura Meksikane, sa u bënë të njohur e mirëpritëshin në mbarë vendin me këtë repertor simpatik.

Kontributi i Selam Mamanit në drejtim të rritjes cilësore të muzikës në estradën profesioniste është mjaft me vlerë, evident dhe me një kohëzgjatje nga viti 1955 deri në vitin 1994. Pra për 40-vjet Selam Mamani nuk u nda nga kolegët e tij muzikantë ku me fizarmonikën e tij debutoi në të gjithë skenat e vendit në qytet e në fshat, gjithmonë i palodhur, gjithmonë korekt e me përgjegjësi profesionale, duke u bërë një shembull pozitiv ku duhet të referohen brezat e rinj të muzikantëve. Karakteri i fortë, një pasion e dëshirë e madhe për muzikën, respektimi, mirënjohja dhe bashkëpunimi i ngushtë me kolegët, puna e pandërprerë me fizarmonikën në krahë për dekada të tëra, ishin vlera dhe veti pozitive të Selam Mamanit që, ndonëse pa arsim muzikor, të ngelet një nga figurat më prestigjioze të qytetit të Gjirokastrës. Aktiviteti i Selamit nuk kufizohet vetëm në Estradën, Profesioniste e në lëvizjen amatore, por ai është mjaft i gjerë e i larmishëm. Në atë kohë çdo aktor e muzikant i estradës profesioniste kishte në patronazh, siç i thoshin, për të ndihmuar një ndërmarje të qytetit ku do të përgatisnin një shfaqje artistike me vetë punëtorët e asaj ndërmarrje. Ishte kjo një detyrë shtetërore dhe ndiqej gjatë gjithë vitit nga aktorët dhe muzikantët me qëllim që të gjallërohej jeta kulturore dhe artistike në qytet. Selami ishte i vetmi nga këta artistë që punonte me plot pasion në dy ose tre ndërmarrje njëkohësisht

dhe atje ku punonte ai, ajo ndërmarrje me siguri do të vlerësohej në takimin e qëndrave të punës me çmime të para. Takimi i estradave të qëndrave të punës vazhdonte rreth një muaj dhe përveç gjallërimit të jetës artistike në qytet, evidentonte edhe talente të reja si aktorë e këngëtarë amatorë, shumica e të cilëve do të merrnin pjesë edhe në estradën profesioniste, në teatrin e qytetit, në teatrin e kukullave, në trupën e cirkut si dhe të grupeve artistike të pallatit të kulturës.

Para disa dite vjen dhe më takon Hysen Qenej nga fshati Asim Zeneli.

“Të kam ndjekur mbrëmë në televizor, më tha dhe u gëzova shumë që po shkruan një libër për muzikantin e nderuar Selam Mamani.

Kam edhe unë respekt e lidhje të ngushta miqësore me Selam Mamanin. Të kam sjellë edhe një fotografi, ku kam dalë duke kënduar në një festival në shesh të Çerçizit e Selami më shoqëron me fizarmonikë, është e vitit 1962.

Të kam sjellë edhe një letër ku shpreh respektin dhe mbresat për këtë njeri të mrekullueshëm. Po deshe mund ta vendosësh në libër”.

U befasova nga ky takim emocional dhe i premtova se do ta vendosja letrën në libër.

Ja çfarë shkruan Hysen Qenej për Selam Mamanin:

“Selami ka qënë një burrë që komunikonte me këdo. Ka patur nivel të lart organizativ. U bëra mik familjar qysh në vitin 1962. Sebeu u bë zhvillimi i këngës popullore të zonës së Lunxhit që u zhvillua në Sheshin e Çerçizit. Unë kisha dëshirë të këndoja një këngë të shoqëruar me fizarmonikë, por atë kohë nuk kishte instrumentistë në fshat. Kësaj dëshire ju përgjigj menjëherë muzikanti i talentuar Selam Mamani. Erdhi në fshat dhe qëndroi



*Petrit Lulo dhe Orkestra e Estradës Profesioniste në koncert para një reparti ushtarak*

një javë rresht dhe fjeti në familjen time. Aty unë njoha thjeshtësinë e tij, me njerzit e thjeshtë e të varfër në atë kohë. Nuk pretendonte për jetesën, por u familjarizua të hante në shtëpinë time ato që na ndodheshin. Dëshirë dhe qejf kishte që të hante çdo mëngjes përshesh me dhallë, me bukë misri.

Brenda javës Selami u bë mik familjar për mua dhe gjithë fshatin. Në çdo aktivitet me rëndësi Selami që i gatshëm për rininë e fshatit.

Kjo foto flet për një këngë dashurie që unë e realizova me të renë e fshatit Evanthi Haxhiaj dhe zumë vendin e parë në zonë”.


Një kontribut në zhvillimin e lëvizjes amatore të qytetit në ato vite ka dhënë edhe mësuesi i nderuar Aleko Pano. Profesor Alekua ishte mësues i historisë në shkollën “Pedagogjike”, por

ai duke qënë se ishte edhe muzikant e i binte shumë mirë fizarmonikës, ka dhënë një kontribut të shquar në gjallërimin e jetës artistike të shkollës e në lëvizjen amatore të qytetit. Shkolla “Pedagogjike” kishte në atë kohë një ansambël artistik të mrekullueshëm, ku bënte pjesë një kor i madh, grupi i valleve, kompleksi volkal, solistët, recituesit si dhe grupin e mandolinatës, të mirënjohur në rrethin tonë që e drejtonte muzikanti e mjeshtri i mandolinës, Vaso Buka. Profesor Alekua ishte i apasionuar mbas muzikës dhe, krahas vlerësimeve të larta që merrte nga kolegët e seksioni i arsimit si dhe respektin e madh që kishin nxënësit e tij si mësuesi i historisë e që për të gjitha këto merita është dekoruar me titullin “Mësues i merituar”, ai ishte edhe një nga muzikantët më me vlerë në vitet 50-70-të në Gjirokastrë. Shfaqjet që jepte shkolla “Pedagogjike” në atë kohë ishin me vlera artistike, por njëkohësisht ato ndikonin edhe në edukimin, përgatitjen dhe evidentimin e talenteve të reja. Në ato aktivitete u evidentuan nxënësit e talentuar, Zhaneta Papamihali, që më vonë u bë një aktore e talentuar e teatrit profesionist të qytetit. Po nga këto aktivitete doli dhe u evidentua edhe nxënësja Krisanthi Kallulli që punoi për një kohë të gjatë si aktore në estradën profesioniste.

Një ndihmesë në lëvizjen amatore të qytetit ka dhënë dhe mësuesi i muzikës Niko Naka. Nikua e zotëronte mjaft mirë fizarmonikën dhe ishte ndër instrumentistët më kryesorë që përgatisnin në Pallatin e Kulturës, aktivitetet e ndryshme artistike. Në këtë ambjent të gjallë, midis miqsh e kolegësh artistë e zhvilloi veprimtarinë e tij muzikore edhe Selam Mamani. Përveç vlerave të mëdha që ka si muzikant, Selami ishte edhe një shok mjaft i mirë e shumë i dashur e i respektuar nga kolegët e tij. Unë kam qëndruar për rreth 40 vjet shumë afër Selamit dhe nuk kujtoj asnjë moment të këtij bashkëpunimi

të gjatë ku Selami të ketë prishur qejfin me ndonjërin nga shokët e tij. Është ky një rast i rrallë në jetën e komunitetit artistik të qytetit dhe një shembull pozitiv që brezat e rinj kanë ku të drejtohen e të përfitojnë nga vlerat dhe shpirti i gjerë i Selam Mamanit.

Duke shkruar këtë libër kam pyetur dhe u jam drejtuar shumë kolegëve të Selamit për të marrë mbresa dhe kujtime si dhe për të saktësuar ngjarje e veprimtari artistike, ku ata kanë qënë pjesëmarrës bashkë me të dhe gjithë pa përjashtim, përveç vlerave të mëdha që ka si muzikant, janë shprehur dhe kanë vlerësuar zemërgjerësinë e tij, shpirtin e humorit, dashurinë e respektin për njëri tjetrin, këmbëngulës e i pa lodhur në çdo shfaqje, shpirtin e madh të sakrificës, i thjeshtë e pa pretendime.



*Këngëtarja Majnure Kadena në një shfaqje*

Të gjithë kolegët e tij Ruzhdi Lluri, Dhosi Margariti, Merjeme Mevlani, Teli Stefani, Nebaher Skëndi, Aleko Pano, Bernard Kokalari, Andon Pilo, Jorgo Roze, Petrit Lulo, Ksenofon Andrea, Saimir Skënduli, Raqi Paskali, Miço Kasapi, apo edhe ata që nuk janë më sot në Gjirokastrë si Arqile Garo, Raimonda Aleksi, Dhimitër Bocollo, Kosta Loli, Kozma Kaftani, etj, që unë kam kontaktuar gjatë kësaj kohe, më kanë

befasuar me konsideratat e larta që shprehin për Selam Mamanin si muzikant, njeri e personalitet shoqëror. Jo vetëm këta miq e koleg që takova në këto ditë, por edhe ata që nuk jetojnë më, ndaj të cilëve përhulem me respekt e i kuitoj me mirënjohje si Izet Mato, Rustem Asqeri, Maliq Çomo, Xhina Papakosta, Polo Ndreu, Medi Baduni, etj, gjithmonë kanë shprehur vlerësime të larta për Selamin dhe ish-in miqtë e bashkëpunëtorët e afërt me të.

Kur gjen një mbështetje kaq masive nga njerëz që kanë punuar pranë tij nga fillimi i viteve 50-të e deri në vitin 96-të të ritet respekti e obligimi ndaj tij dhe konsolidohet ky personalitet i muzikës në Gjirokastrë.

Estrada profesioniste e Gjirokastrës ka zhvilluar një veprimtari të dendur artistike. Në se do t'u referohemi shfaqjeve që ajo ka dhënë qysh nga krijimi i saj në vitin 1955 e deri në fillim të viteve 90-të, kur ajo u shkri si trupë profesioniste dhe pushoi aktivitetin e saj, janë vënë në skenë rreth 110 premiera dhe ka dhënë mbi 4000 shfaqje në qytet e fshat dhe rrethe të ndryshme të vendit me mbi 300.000 spektatorë, shifra këto që tregojnë për një punë mjaft pozitive e me vlera në drejtim të gjallërimit të jetës kulturore-artistike të qytetit tonë. Kanë punuar në këtë trupë profesioniste në periudha të ndryshme kohore rreth 11 regjisorë të ardhur nga Tirana, por edhe të vetë qytetit ku mund të përmendim: Prokop Mima – Gjon Daka – Thanas Gjoka – Tomi Mato – Teli Stefani – Dhimo Dhima – Petro Kosta – Bernard Kokalari – Andon Pilo e Arqile Garo. Estrada e Gjirokastrës shpesh herë është nderuar me vende nderi në takimet në rang vendi e ato rajonale. Kanë patur një aktivitet të suksesshëm e për vite me radhë aktorët e mirënjohur si Izet Mato, Teli Stefani, Ruzhdi Lluri, Merjeme Mevlani, Kaman Çabej, Dhosi Margariti, Jorgo Nano, Polo Ndreu, Nebahet



Skëndi, Rustem Asqeri, Koço Lani, Petro Kuci, Fane Biti, Viktor Zhisti, Bukuroshe Kokalari etj, të cilët i kanë dhënë vlera dhe kanë konsoliduar këtë trupë profesioniste.

Një nga figurat qëndrore që ka një veprimtari shumë të gjatë e mjaft produktive në estradën profesioniste të Gjirokastrës padyshim është regjisori dhe shkrimtari humorist Dhimo Dhima. Dhimua me shkrimet e tij plot humor e me nivel artistik si dhe në rolin e regjisorit të estradës, ndikoi ndjeshëm në rritjen profesionale dhe autoritetin e kësaj trupe. Me një krijimtari të bollshme, këmbëngulës, me horizont të gjerë në fushën e humorit, njohës i mirë i skenës, Dhimo Dhima u bë mjaft i njohur në publikun Gjirokastrit e në mbarë vendin. Ai ishte një nga bashkëpunëtorët, miqtë e shokët më të ngushtë të Selamit. Në prag të premierave ata do t'i gjeje të dy bashkë për orë të tëra, derisa përcaktonin meloditë e kupleteve e parodive që shkruante Dhimua e që i muzikonte Selami, duke diskutuar deri tek muzika që do të hapte dhe mbyllte shfaqjen. Bashkëpunimi i tyre ka qënë mjaft i frytëshëm dhe i suksesshëm gjë që e tregojnë premierat e shumta që i kanë drejtuar të dy. Përveç estradës profesioniste, një aktivitet të dendur artistik kishin dhe estradat e qëndrave të punës të rrethit, që ishin rreth 15 dhe që një herë në vit dilnin para publikut me premierat e tyre e paraqiteshin në konkurimin artistik të ndërmarrjeve. Jo vetëm këto, por edhe aktivitete artistike të shkollave 8-vjeçare e të mesme, festivali i pionerëve dhe të rriturve, koncerte të ndryshme nga ansambli i Pallatit të Kulturës e deri tek Festalet Folklorike Kombëtare të Gjirokastrës, gjallëronin së tepërmi jetën kulturore të qytetit, aq sa nuk mund të krahasohet me sot. Aq shfaqje e aktivitete kulturore që bëheshin në një vit në vitet 70-të 80-të, nuk janë bërë në 10 vitet e tranzicionit të marra së bashku.



*Këngëtarët: Petrit Lulo, Eftim Llambro e Dhimitër Jovani në një shfaqje të vitit 1979*

Ajo kohë kaloi nga fyelli i Vehip Qorit tek orkestra simfonike dhe shkolla e muzikës, nga teatri amator i Dine Qallimit tek Teatri Dramatik Profesionist, Estrada Profesioniste, trupa e cirkut, teatri i kukullave etj., të cilat në një periudhë 40-vjeçare, me kontributin e dhjetra artistëve që punuan me përkushtim e investuan potencialin e tyre artistik e intelektual në shërbim të shoqërisë.

Nuk dua të ndalem në shembuj të tjerë e të evidentoj vlerat e estradës profesioniste të Gjirokastrës mbasi aktiviteti i saj vlerat edukative, humori i hollë, niveli artistik, figurat prestigjioze që debutuan në këtë trupë tregojnë se Gjirokastra e këtyre viteve ka pasur një aktivitet të dendur e që kanë ndikuar në nivelin kulturor të qytetit. Duhet theksuar se në vitin 1968 u krijua trupa e Teatrit Dramatik profesionist me regjisorin e parë Bernard Kokalari. Në fillim të viteve 80-të u krijua orkestra



*Këngëtarja Hëna Xhemali në një shfaqje të vitit 1971*

sinfonike amatore e Pallatit të Kulturës me 40 muzikantë e me dirigjent Roland Çenen. Në vitin 68-të u çel klasa e parë e shkollës së muzikës e cila në vitin 1979 u shndërrua në shkollën e Mesme Artistike duke u bërë çerdhe e edukimit të talenteve të reja. Pra vlerat artistike kulturore të qytetit erdhën gjithnjë në rritje dhe tashmë Gjirokastra renditej në qytetet kryesore të vendit.

Duke ju rikthyer edhe një herë aktivitetit dhe veprimtarisë së Estradës Profesioniste në mesin e viteve 60-të, përveç këngëtarëve Maliq Çomo e Rustem Asqeri, në këtë trupë morën pjesë dhe këngëtarët e rinj Hëna Xhemali e Anesti Nase. Selami interesohej për gjetjen e repertorit për këta këngëtarë e sidomos për më të rinjtë Hënën e Nestin. Hëna ishte rreth 15 vjeç kur hyri si këngëtare profesioniste në estradë. Ajo kishte një zë shumë të bukur e melodioz e i këndonte me pasion këngët që i

caktonte Selami. Ajo kishte disa vjet që këndonte në festivalet e pionierëve dhe për zërin e saj të mrekullueshëm dhe interpretimin me plot pasion të këngëve që këndonte, vlerësohej me çmime të para e pritej me duartrokitje e dashamirësi nga spektatori gjirokastrit. Selami i ndihmonte shumë Hënën e Nestin, jo vetëm në përvetësimin e këngëve dhe trajtimin e tyre lokal e interpretativ, por edhe durim e pasion ai u mësonte atyre edhe notat muzikore. Nesti erdhi si profesionist në estradë, nga lëvizja amatore, ai kishte një zë karakteristik prej tenori dhe i shkonin përshtat sidomos këngët me motive të Veriut. Ai kishte sukses e mirëpritej jo vetëm nga spektatori në Gjirokastër, por edhe në qytete të tjera nga Jugu në Veri, ku estrada jonë bënte turne të gjata me shfaqje.

Në mesin e viteve 70-të në estradën profesioniste erdhën dhe këngëtarët Petrit Lulo dhe Eftimi Llambro. Petriti sapo kishte mbaruar ushtrinë në trupën artistike të Ansambllit të Ushtrisë në Tiranë dhe vinte me një përgatitje të mirë vokale e më një zë shumë të bukur e të veçantë në interpretimin e këngës, gjë që u vërtetua shumë shpejt e që e bëri atë të njohur ndër këngëtarët më të mirë të vendit, ndërsa Eftimia vinte nga bankat e shkollës së mesme me një veprimtari të gjerë si interpretuese e këngëve për pionierë e të muzikës së lehtë. Selami ndikoi që këta këngëtarë të vinin në estradë si profesionistë mbasi kishte besim në talentin e tyre si dhe në pasionin që kishin për muzikën. Ai punonte me durim e pasion me ta edhe për ngritjen e tyre profesionale, hartoi një program pune ku qysh në fillim të punës ai zhvillonte me ta vokalica për të ruajtur vlerat e vokalit e për të zgjeruar diapazonin dhe shtrirjen e tij, metoda këto mjaft efikase për ngritjen profesionale të këngëtarit. Si rezultat i kësaj ndihmese shumë të madhe e për vite me radhë që Selami u dha Petritit dhe Eftimisë, ata u bënë këngëtarë



*Parodistët e estradës; Rustem Asqeri, Polo Ndreu e Petro Kuci në një shfaqje të vitit 1979*

mjaft të mirë e, mirënjohur në mbarë vendin.

Selam Mamani preokupohej shumë në kohën e përgatitjes së premierës së estradës. Ai kërkonte me durim këngë për gjithë këngëtarët që këndonin në estradë, duke gjetur për secilin atë këngë që i përshtatej vokalit e karakterit të zërit të tij. Ishte kjo përzgjedhje profesionale e kjo njohje që ai kishte deri në imtësi për veçoritë e vokalit të secilit këngëtar, gjë që bënte të mundur që të gjithë këngëtarët të paraqiteshin me dinjitet para spektatorit. Si rezultat i një pune të gjatë profesionale që bëhej në gjithë kolektivin e muzikës nën drejtimin e Jorgo Rozes e të Selamit, ky sektor vlerësohej e kishte sukses në shfaqjet para publikut në Gjirokastrë, në qytete të tjera të vendit e në takimet kombëtare. Në fillim Maliq Çomo e më vonë Petrit Lulo u bënë të njohur në mbarë vendin me pjesëmarrjen e tyre në



*Aktorët Petro Kuci, Teli Stefani dhe Nebehat Skëndi  
një shfaqje të vitit 1988*

festivalet e këngës në Radio-Televizion.

Në orkestrën e estradës kanë punuar shumë muzikantë që vinin nga shkollat e mesme artistike si dhe nga lëvizja amatore si Selam Mamani, Jorgo Roze, Shkëlqim Skreli, Ksenofon Andrea, Alma Peshkëpia, Polo Xhori, Aleko Pano, Odise Çaro, Mihal Dako, Niko Naka, Vaso Naka, Aleko Kosta, Mentor Darova, Dhimitër Bocollo, Tomi Rami, Kujtim Dule, Roland Çomo etj; gjithashtu janë aktivizuar edhe këngëtarët Maliq Çomo, Rustem Asqeri, Petrit Lulo, Eftimi Llambro, Vitore Rusha, Dhimitër Jovani, Anesti Nase, Hëna Xhemali, Xhelal Angoni, Luljeta Haxhi etj, si dhe komplekset vokale nga

shkollat e mesme dhe qëndrat e punës, të cilët aktivizoheshin sipas premierave që jepte kjo trupë profesioniste.

Me të gjithë këtë kolektiv muzikor Selam Mamani kishte një shoqëri shumë të ngushtë dhe respektohej e vlerësohej për pasionin e profesionalizmin që kishte dhe për punën e përbashkët që bënin duke respektuar njeri tjetrin. Në vitet 80-të në estradë erdhi këngëtarja e mirënjohur, pjesëmarrëse në festivalet folklorike kombëtare të Gjirokastrës, si përfaqësuese e rrethit të Pukës, Vitore Rusha. Ajo kishte një zë mjaft të bukur karakteristik, melodioz dhe, duke kënduar këngët e trevave folklorike të Veriut u bë e dashur dhe e respektuar nga spektatori gjirokastrit. Krahas këtij bashkëpunimi të gjerë me komunitetin artistik të qytetit, Selam Mamani kishte një bashkëpunim dhe mirëkuptim të ngushtë shoqëror edhe me regjisorin e teatrit të kukullave Osman Buzo. Ai ka kompozuar muzikën e shumë premierave të këtij teatri duke u bërë kështu një nga protagonistët kryesorë muzikant që ndihmuan në rritjen cilësore të kësaj trupe amatore, por me veprimtari të gjerë e vlera artistike. Selami kishte tek Osman Buzua mikun, shokun e bashkëpunëtorin e ngushtë. Ai jo vetëm që kompozonte muzikën e shfaqjeve të teatrit të kukullave, por edhe interesohet që të inçizonte me një formacion muzikor, të gjithë këtë muzikë duke vlerësuar rëndësinë që kishte ajo për të rritur vlerat e shfaqjes.

Në vitin 1989 erdhi në estradën profesioniste si drejtues i orkestrës kompozitori Saimir Skënduli që para një viti kish mbaruar studimet në Institutin e Lartë të Arteve. Saimiri gjeti tek Selami kolegun dhe mbështetësin për çdo problem që kishte sektori i këngëtarëve dhe orkestrës në Estradë.

Në atë kohë ky sektor kishte 7 muzikantë dhe zhvillonte një aktivitet cilësor duke ritur vlerat e shfaqjeve.



*Kolektivi i Estradës Profesioniste në vitin 1988*

Saimiri ishte djalë i talentuar dhe i bënte vetë të gjitha orkestracionet për orkestrën e estradës, megjithatë ai bashkëpunonte me Selamin për paroditë dhe përgatitjen e solistëve, që në atë kohë ishin Petriti, Eftimija dhe Viktore Rusa.

Të gjithë muzikantët gjenin tek Selam Mamani mbështetje e ndihmë konkrete, duke filluar nga orkestracionet e këngëve, përgatitjen e tyre me shumë dashuri e përgjegjësi në shfaqjet e estradës, të ndërmarrjeve, festivalet e pionierëve e të rriturve e deri tek kopjimi i partive për çdo instrumentist të formacionit orkestral me një shkrim si kaligrafi e që na befasonte të gjithëve. Gadishmëria e tij për të ndihmuar kolegët ka qënë e madhe dhe nuk mërzitej e nuk thoshte kurrë jo, por në çdo orë ai rrinte me fizarmonikë në krahë e mbaronte para afatit ato ç'ka ne i kërkonim. Jo vetëm ne që punonim së bashku me të si profesionistë, por edhe çdo amator a drejtues i kulturës të zonave të





*Orkestra e estradës në vitin 1988*

*(Nga e majta lart në këmbë) Jorgo Roze, Aleko Kosta, Shkëlqim Skreli, Selam Mamani, Stefan Stefani, Dhimitër Bocolli*

rrethit, gjente shokun dhe bashkëpunëtorin e afërt tek Selami. Sa herë ka shkuar Selami në fshatra të ndryshme të rrethit për të përgatitur një këngëtar, kompleks vokal a një numër të tërë estrade. Nuk ka pasur drejtues të kulturës të zonave të rrethit që të mos ketë sjellë fizarmonikën e fshatit për ta rregulluar tek Selami, i cili menjëherë mbyllej në kabinat e skenës tek Pallati i Kulturës dhe me durim, për orë të tëra, punonte duke i vënë ndonjë fryzë a tast, apo ngjiste me lifkoplast kacekun e çarë të



*Këngëtarja Vitore Rusha në një shfaqje në vitin 1987*

fizarmonikës, mbasi e dinte se pa të fshati do të mbetej si i shurdhër. Selami kishte një bashkëpunim dhe miqësi të ngushtë me drejtuesit e kulturës të zonave si me Halil Bilaj në Picar, Gëzim Bistri në Mashkullorë, Kudret Shehu e Koço Vasili në Lunxhëri, Koço Lani në Odrie, Jorgo Telo në Zagorie, Foto Paguna në Libohovë, Jorgo Ison në Poliçan, Mihal Këçaqin në Dropull të Sipërm, Lefter Kondo në Dropullin e Poshtëm, Elmaz Haxhinë në “Asim Zenel” etj, të cilët i respektonte dhe i ndihmonte shumë në zhvillimin e aktiviteteve të tyre kulturore e artistike që zhvilloheshin në atë kohë në çdo zonë e që ishin të shumta duke gjallëruar jetën artistike të fshatit. Selam Mamani ka dhënë një ndihmesë mjaft të vyer edhe në përgatitjen e fizarmoniçistëve të rinj që vinin nga fshatrat e rrethit e që vazhdonin kurse 6 mujore, të organizuara nga Pallati i Kulturës. Shumë nga këta instrumentistë të rinj u kthyen në

fshatrat e tyre dhe zhvilluan aktivitete të ndryshme artistike.

Ishte kjo jetë plot veprimtari e mardhënie të ngushta shoqërore për dekada të tëra me miq e shokë në Pallat të Kulturës e në estradën profesioniste, në ndërmarrje prodhimi e në fshatrat e rrethit, njohje me qindra njerëz, ato që e bënë Selam Mamanin një njeri shumë të njohur publik e të respektueshëm nga të gjithë, aq sa sot që ai nuk jeton, të jetë i pranishëm në çdo aktivitet e bisedën tonë si një muzikant i talentuar e një njeri me vlera.

Përveç këtij aktiviteti të gjerë artistik që përshkruam në këtë kapitull, ajo që i jep Selam Mamanit një vend të rëndësishëm e me vlerë në muzikën e qytetit tonë është:

## KRIJIMTARIA

Krijimtarinë e tij muzikore Selam Mamani e filloi që në moshën e rinisë. Me fizarmonikë në krahë, në dhomën e muzikës të shtëpisë së Kulturës në fillim të viteve 50-të, ai hodhi në pentagram notat e para të këngëve të tij të çiltra. Fillon kështu rrugën e vështirë të artit muzikanti i ri Selam Mamani, pa ditur se për 50-të vjet rresht do të konsolidonte figurën e tij artistike me një krijimtari të bollshme e me vlera artistike, duke u bërë një nga muzikantët e mirënjohur të qytetit tonë e më gjerë.

Duke shkruar këtë libër dhe sidomos kapitullin e krijimtarisë, krahas memories time, pra asaj se çfarë mbaj mend



*Festivali i I-rë i Këngës për fëmijë e pionierë në vitin 1964, drejtuar nga Selam Mamani*



*Trupa e Estradës Profesioniste dalë në turne në vitin 1981*

nga krijimtaria e Selam Mamanit, më është dashur që, për të konkretizuar atë saktësisht, të kërkoj dhe t'u drejtohem edhe institucioneve kulturore artistike të qytetit, por për fat të keq shumë pak dokumenta të tillë gjeta.

Pallati i Kulturës nuk ka as edhe një fotografi, partiturë, fletë muzike, historik të institucionit etj, një fatkeqësi dhe humbje e madhe kjo, jo vetëm për krijimtarinë e Selam Mamanit, por për gjithë muzikantët që kanë kontribuar në këtë institucion nga viti 1946 e deri më sot. Ky është një realitet i dhimbshëm dhe mjaft shqetësues për të gjithë atë pjeladë muzikantësh që për dekada me radhë kanë investuar në Pallatin e Kulturës krijimtarinë e tyre, shpesh herë me cilësi të lartë artistike e me vlerësime në aktivitetet lokale e kombëtare. Po kjo gjëndje është edhe në Qendrën Kulturore të fëmijve "Fato Berberi", ku nga 39 festivale të fëmijve që ka organizuar ky institucion, ndodhen partiturat e 3-4 festivaleve të fundit. Ndërkohë që Selam Mamani ka qënë pjesëmarrës me

krijimtarinë e tij nga Festivali i Parë në vitin 1964 e deri në vitin 1996. Ndërsa në Teatër-Estradë gjëndja është më ndryshe, pasi në dosjet e programeve gjenden edhe materiale muzikore, por kjo përsëri e pa mjaftueshme mbasi nuk janë dokumentacioni i premierave për të gjitha vitet, nga 1955 kur është themeluar Estrada Profesioniste.

Duke pirë kafe me këngëtarin e mirënjohur, bilbilin e këngës Gjirokastrite Petrit Lulo, që para disa kohe Këshilli Bashkiak e ka nderuar me titullin e lartë “Qytetar Nderi”, i kërkova të më tregonte diçka nga marrdhëniet dhe bashkëpunimi që ka pasur me Selam Mamanin. Dhe Petriti fillon: “Selami ishte miku im më i mirë dhe në të gjitha sukseset e arritjet që kam pasur në jetën artistike deri tek titulli i fundit, është edhe ndihmesa e kontributi i tij”. I them të më tregojë diçka nga aktiviteti 21-vjeçar pranë Selam Mamanit, nga qindra shfaqje në turne të ndryshme në qytete e fshatra, nga bashkëpunimi me këngët e tij, diçka nga jeta intime etj. Dhe Petriti nisi të tregojë:

“Në vitin 1974 kur u ktheva në Gjirokastër, mbas mbarimit të shërbimit ushtarak që e kreu në Ansamblin e Ushtrisë në Tiranë, dëshiroja të aktivizohesha në Estradën Profesioniste të qytetit, prandaj shkova tek shokët e sektorit të muzikës të më dëgjonin e të më jepnin vlerësimin e tyre për aftësitë e mia si këngëtar. Isha djalë i ri dhe kisha emocione. Mbasi këndova disa kënga ku në fizarmonikë më shoqëronte Selami, të gjithë më falenderuan e më thanë se kisha zë shumë të mirë, ndërsa Selami ju tha atyre se ky djalë ka një zë “kadife”. Më bëri përshtypje ky përkufizim i tij dhe kështu do të më thoshte e do të më vlerësonte gjatë gjithë kohës që punuam së bashku. Mbasi pak kohe unë fillova punë si këngëtar në Estradën Profesioniste dhe Selami do të interesohet për repertorin tim dhe jo vetëm

për këngët që merreshin nga Festalet e Radios, dekadat e Majit në Tiranë etj, aktivitete artistike, por do të kompozonte edhe vetë këngë për ne këngëtarët e Estradës. Janë mjaft të njohura e me vlera të larta artistike potpuritë e tij “Dje një mal me halle, sot një det me këngë”; Potpuri me motive të Jugut etj, të cilat i këndonim unë, Eftimia, Dhimo Jovani e Xhelal Angoni.

Ishin këto krijimet më të bukura të Selamit të cilat edhe sot që trasetohen nga televizioni shtetëror e ato lokale, pëlqehen dhe artëdashësit Gjirokastrit, sa herë që na takojnë në rrugë, na falenderojnë për këto këngë të bukura që kemi kënduar. Ne si sektor i muzikës në Estradën Profesioniste ishim një kolektiv kompakt që e donim dhe e respektonim njeri tjetrin. Selami, Jorgua, Eftimia, Kimia, Fonia, Viktoria, Alma, Teuta, Stefani, Jani, Saimiri etj, por edhe amatorët e shumtë që aktivizoheshin në premierat e ndryshme, punonin me



*Këngëtarët Petrit Lolu dhe Liljana Kondakçi në një shfaqje të vitit 1976*

këtë shqetësim unë do të rekomandoja që institucionet kulturore e artistike të qytetit në programet e tyre vjetore të planifikojnë që, në forma e mënyra të ndryshme, duke ju drejtuar institucioneve homologe në Tiranë e gjetkë si dhe individëve artistë në Gjirokastrë, të grumbullojnë sado pak nga tërë ajo krijimtari e bollshme artistike, duke bërë të mundur që të krijohet fondi i krijimtarisë artistike të krijuesve gjirokastritë.

Por tani le ti kthehemi krijimtarisë së kompozitorit Selam Mamani. Krijimtaria muzikore e Selam Mamanit jo vetëm që është shumë e bollshme në numër, ku radhiten rreth 300 këngë e pjesë të ndryshme, por ajo është mjaft e pasur dhe e larmishme në tematikën e saj. Selami ka kompozuar tipe të ndryshme këngësh, duke filluar nga këngët e fëmijve, të muzikës së lehtë, përpunime të këngëve popullore dhe këngëve të mbështetura mbi këto motive.

Në krijimtarinë e tij zënë vend këngët solo, dueto, trio, këngë për kompleks vokal etj, të ndërtuara mbi ritme të ndryshme duke filluar nga ato të muzikës popullore si  $7/8 - 5/8 - 4+5/8 - 6/8$ , apo ritme të thjeshta si  $2/4, 4/4$  etj, dukuri pozitive kjo që e bën të larmishme krijimtarinë e tij. Duke pasur një krijimtari kaq të bollshme në numër, ajo shtrihet edhe në një tematikë mjaft të larmishme. Në këtë tematikë kaq të gjerë përfshihen këngë për jetën e fëmijve, për nënën, mësuesin, shkollën, dashurinë, për fshatin, për jetën e re, për kurbetin etj, duke evidentuar tërë gamën e gjerë të aspekteve të jetës. Në shumë këngë, përveç muzikës, Selami ka shkruar edhe tekstin e tyre. Ai i shkruante vetë disa nga tekstet e këngëve për të shprehur më qartë idenë dhe unitetin ndërmjet muzikës dhe fjalëve dhe, për të realizuar një krijim të tij, ajo këngë ishte mjaft e bukur dhe pa difekte. Kaq shumë tekste këngësh ka krijuar Selami sa po t'i grumbullosh ato, mund të krijohet një





*Orkestra e Estradës e drejtuar nga Selam Mamani në një shfaqje në vitin 1979*

libër me poezi mjaft interesante. Por Selami në kompozimet e tij bashkëpunonte edhe me shkrimtarët e letrarët e rrethit, të cilët ishin miqtë e tij, që i donte e i respektonte shumë. Ai bashkëpunoi me Bekim Harxhin, Agim Shehun, Pano Çukën, Tasim Gjokutën, Petro Çerkezin etj. Përveç këngëve të shumta Selami ka kompozuar edhe muzikë në shumë shfaqje të teatrit të kukullave, ku ishte regjisor Osman Buzo. Bashkëpunimi i tyre ishte shumë i ngushtë e mjaft i frytshëm, ata ishin miq dhe e donin dhe e respektonin shumë njeri tjetrin. Muzika që bënte Selami për teatrin e kukullave ishte mjaft interesante. Ajo i përshtatej botës së fëmijve dhe nëpërmjet personazheve të kafshëve që kishte shfaqja, ai muzikonte sipas veçorive të tyre dhe me mjetete shprehëse bënte të dallohej ujku nga ariu, dhelpra nga dhia etj.

Përveç këtij bashkëpunimi Selami punoi për shumë vite

edhe me Sotiraq Paskalin si drejtues i cirkut në qytetin tonë. Raqi ishte themeluesi i cirkut profesionist ku bënë pjesë 6 pjestarë dhe pasioni ndaj këtij arti dhe puna e palodhur për dekada me radhë, e bënë atë të njihet në mbarë vendin e të jetë i nderuar e i respektuar. Selami kishte një shoqëri të ngushtë me Raqin. Ai e vlerësonte punën që bënte kolektivi i cirkut, prandaj merrte fizarmonikën në krahë dhe shkonte në palestrën e tyre, e cila ndodhej në godinën e xhamisë në mes të pazarit dhe bënte prova me ta duke ilustruar numrat akrobatikë me muzikë të ndryshme. Në atë kohë xhamija ju dha akrobatëve të cirkut, të cilët e kthyen në arenën e tyre ku jepnin për vite me radhë shfaqjet e bukura. Selami rrinte me orë të tëra në atë arenë cirku dhe bashkëpunonte me Raqin për të përcaktuar masat muzikore dhe efektet që do të ilustronin çdo numër akrobatik. Motivët e tij ishin të mbështetura në pentatonin e Jugut. Këngët e tij ishin mjaft optimiste e të gëzuara, me një motiv të thjeshtë e të kuptueshëm dhe që perceptohej shpejt nga dëgjuesit. Këngët e tij që paraqiteshin në festivalet e fëmijve mësoheshin shumë shpejt nga ata, por edhe nga dëgjuesit në sallë. Selami për këto këngë të bukura që kompozonte do të nderohej me çmime nderi në Festivalet e aktivitetet e ndryshme artistike. Selami kishte një krijimtari sistematike dhe kompozonte gjatë gjithë vitit për aktivitetet e ndryshme që organizoheshin në rreth si: “Takimi i qëndrave të punës e i zonave”, për estradën profesioniste, për festivale e takimin e shkollave të mesme e mjaft aktivitete të tjera. Është ky angazhim i përhershëm me krijimtarinë e tij në aktivitetet e rrethit që e bënë Selam Mamanin një ndër kompozitorët më prodhimtar në Gjirokastër. Pikërisht për tërë këtë krijimtari të gjerë e të larmishme që na ka lënë si dhe për kontributin e çmuar që ka dhënë në zhvillimin e artit muzikor në Gjirokastër, Selam

Mamani vlerësohet sot nga gjithë komuniteti artistik si një figurë prestigjioze në kulturën e qytetit.

Një krijimtari të bollshme muzikore Selami pati edhe në kompozimin e kupleteve e parodive. Në vitet 60-të ato u bënë pjesë e rëndësishme dhe e domosdoshme në shfaqjen e estradës. Selami punonte me shumë kujdes dhe me profesionalizëm muzikor në kompozimin e parodive dhe të kupleteve. Të gjitha paroditë e estradës pothuaj i kompozonte Selami. Ai krijonte melodi mjaft interesante, por edhe të përshtatura për vokalin e parodistëve që i këndonin si dhe në një unitet të muzikës me tekstin. Në vitet 80-të në estradë u formua një trio parodistësh mjaft të mirë e të suksesshëm me Rustem Asqeri, Polo Ndreu e Petro Kuci. Loja e tyre aktorese mjaft e mirë në regjinë e Dhimo Dhimës si dhe meloditë aq të bukura e funksionale të Selamit,



*Aktorët Izet Mato e Gëzim Kruja në një shfaqje në vitin 1979*


bënë që kjo trio të njihet në mbarë vendin e të ketë sukses të vazhdueshëm. Të kompozosh muzikën e një parodie nuk është e thjeshtë. Ajo kërkon të përqëndrosh mjaft elementë të domosdoshëm që parodie të bëjë efektin e saj tek spektatori. Brenda një parodia mund të ketë disa variante muzikore; duhet që muzika të ketë karakter gazmor e fraza muzikore të qarta e të kuptueshme, të thjeshta për t'u kënduar nga parodistët por edhe të kuptueshme nga spektatori. Unë vetë, gjatë kohës që kam punuar në estradë, megjithëse kam kompozuar shumë këngë, nuk jam ulur të shkruaj ndonjë kuplet apo parodi. Selami pothuaj ishte bërë mjeshtër i kompozimit të parodive, të cilat zënë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e tij muzikore. Ndryshe nga sot që paroditë ndërtohen mbi motive muzikore të këngëve të ndryshme, si të autorëve të vendit ashtu edhe këngë e melodi të huaja, në vitet 60-80-të ato ishin krijime të reja muzikore dhe kërkonin edhe njohjen e diapazonit të parodistëve, veçoritë individuale të aktorit, të vokalit të tij si dhe zberthimin ideo emocional të vetë tekstit të parodisë, që në tërësinë e saj ky krijim artistik muzikor tekst-interpretim të sillte emocione tek spektatori.

Gjatë kohës që po shkruaj këtë libër jam takuar me shumë kolegë, bashkëpunëtorë e miq të Selam Mamanit për të marrë nga ata mendime, mbresa, kujtime e vlerësime për punën dhe krijimtarinë e tij, në mënyrë që ta paraqes sa më të plotë e reale figurën e tij prej qytetari e muzikanti. Aktori i mirënjohur Teli Stefani më tregonte një ditë për mardhëniet e tij me Selamin që e kishin zanafillën qysh në vitin 1958, kur ai ishte regjisor i estradës profesionale. Dhe Teli tregon: "Në vitin 1958 unë isha regjisor i estradës dhe Selami drejtues i muzikës, kishim një bashkëpunim të ngushtë dhe mundoheshim të realizonim premiera me nivel të mirë artistik. Selami interesohej shumë



*Muzikantë të qytetit të Gjirokastrës në një turne artistik në Francë, në vitin 1990.*

për muzikën në estradë dhe përveç këngëve që ai i siguronte nga miqtë e tij në Tiranë si Agim Prodani, Aleko Kareco etj, ai interesohej e preokupohej edhe për muzikën e parodive. Jo vetëm për ato parodi që muzikën e bënte vetë, por sidomos nga muzika e filmave që shfaqeshin në atë kohë në kinemanë e qytetit. Mbaj mend një parodi shumë të bukur që ishte bërë me muzikën e filmit të “Raxh Kapurit”, një melodi që në atë kohë pëlqejesh shumë nga masa e gjerë e popullsisë. Po kështu edhe një parodi me muzikën e filmit “Arshi Mallalla”, me titull “Dashuri në pleqëri”. Në atë kohë kemi vënë në skenë shumë parodi të tjera të bukura si parodia e “Kursimit”, e shoferave, të cilat linin mbresa e mirëpritëshin nga spektatori jo vetëm në Gjirokastrë por edhe në qytete të tjera ku ne shkonim për të dhënë shfaqje. Unë merrija pjesë e këndoja edhe vetë këto parodi, bile Selami më fuste të këndoja edhe ndonjë këngë trio



*Muzikantë gjirokastritë në Ansamblin në Francë.*

*(Nga e majta - Gjergji Spiri, Naxhi Kasoruho, Ladi Lulo, Selam Mamani)*

me Arta Babëramon e Maliq Çomon. Ai më thoshte se kisha zë të intonuar. Jo vetëm gjatë kësaj kohe ku unë isha regjisor i estradës dhe duhet të bashkëpunoja me Selamin për realizimin e premierave të ndryshme, por gjatë gjithë kohës unë kam gjetur tek Selami shokun, mikun e bashkëpunëtorin artistik. Shpesh herë ne punonim së bashku për realizimin e shfaqjeve në ndonjë ndërmarrje të qytetit për takimin artistik të qëndrave të punës si N.P.A, Uzina Metalike, U.M.B, CIGARE, Fabrika e Këpucëve etj, ku rezultatet kishim mjaft të mira. Jo vetëm në mardhënie pune, por edhe në jetën private, unë kisha tek Selami një mik dhe shok të ngushtë e të sinqertë, prandaj e kujtoj me respekt dhe e vlerësoj maksimalisht kontributin e tij shumë të madh që ka dhënë në sektorin e muzikës në estradën profesionale. Me këtë rast ju falenderoj edhe juve, i dashur koleg e miku im, që po shkruani një libër për Selam Mamanin dhe uroj që të jetë një vepër e mirë, që të evidentohet puna për

dekada të tërë në fushën e muzikës jo vetëm me Selamin por edhe e kolegëve e bashkëpunëtorëve të tij”.

Duke marrë mendime e mbresa nga kolegët e bashkëpunëtorë të Selamit, janë të sigjerta e që e vlerësojnë pozitivisht aktivitetin e tij, ky libër merr një dimesion më të gjerë dhe e plotëson më realisht figurën e këtij muzikanti të mirënjohur të qytetit tonë. Selam Mamani i takon merita për organizimin në qytetin tonë në vitin 1964 të Festivalit të parë të këngës për fëmijë e pionierë. Ishte kjo një ngjarje shumë e rëndësishme në jetën e qytetit. Nis kështu një traditë shumë e bukur e këngës për fëmijë që sivjet, më 2001, shënon Festivalin e 39-të. Selami u morr me gjithë organizimin e këtij festivali duke filluar nga përzgjedhja e këngëve, pjesëmarrjen e fëmijve e të pionierëve, orkestracionet e deri tek drejtimi i festivalit.

Në këtë festival ai u paraqit me këngën “Këndo bilbil për nënën Shqipëri” të kënduar nga pionieri Fatos Puto dhe që u nderua me çmimin e parë. Ishte kjo një këngë mjaft e bukur me motiv muzikor të qartë, melodioze, ritëm të gëzuar e fjalë të bukura, që edhe sot mbas 35 vjetësh, është e freskët dhe renditet në këngët më të bukura të Selamit. Qysh nga ky festival e deri në vitin 96-të Selam Mamani do të ishte present në të gjitha festivalet e pionierëve me këngët e tij të bukura, ku gjithmonë do të vlerësohej me çmime nderi.

Selami u bë një ndër kompozitorët më të dashur të fëmijve, këngët e tij do të këndoheshin me endje e do të mësoheshin menjëherë nga ata që ditët e para mbas festivalit. Pikërisht për këtë krijimtari të bollshme të bukur, për larminë e saj tematike e melodike, për këngët për fëmijë e të rritur, të krijuara për dekada të tëra, Selam Mamani është muzikanti i respektuar e i nderuar nga mbarë komuniteti artistik, publiku i qytetit e më gjerë. Për vlerat artistike që ka krijimtaria e tij ajo është prezente

edhe sot në transmetimet e Radios e Televizionit shtetëror të Tiranës si një dukuçi positive e veprës të këtij muzikanti të talentuar të qytetit tonë.

Selam Mamani është muzikanti me veprimtari artistike krijuese më të gjatë ndër muzikantët e qytetit. Ai e filloi aktivitetin muzikor qysh në vitin 1955, në estradën profesioniste në Pallatin e Kulturës dhe e mbaroi në vitin 1996, kur u nda nga jeta. Ai bashkëpunoi dhe harmonizoi të gjithë brezat e muzikantëve që zhvilluan aktivitetin e tyre në Gjirokastrë. Krijimtaria e gjerë, vlerat artistike të saj, komunikimi i gjatë e aktiv me spektatorin, janë vlera pozitive të kompozitorit të mirënjohur Selam Mamani, ndaj të cilave ne miqtë e kolegët e tij ndjejmë respekt dhe përulemi me nderim duke e ndjerë përgjegjësinë morale e detyrimin artistik e qytetar për ta propaganduar dhe ekspozuar maksimalisht veprën e tij me vlerë.



## JETA PRIVATE

Qysh kur ishte i ri e i binte fizarmonikës në provat e grupit të baletit në Pallatin e Kulturës Selami u njoh dhe u dashurua me një vajzë shumë të bukur, që e kishte emrin Donika. Nuk e imagjinonte në ato momente se dashuria për Donikën do t'i sillte shqetësime e do të kalonte në shumë peripeci, derisa të realizonte martesën me të. Donika ishte e fesë ortodokse dhe e kishte shtëpinë në fund të kalldrëmit të lagjes “Varosh”, ndërsa Selami i përkiste fesë muslimane dhe shtëpinë e kishte në lagjen “Palorto”, ngjitur me shkollën “Urani Rumbo”. Kjo ndasi fetare



*Selami me Anene - Nënë e tij.*



*Selami me bashkëshorten, Donikën.*

ishte një pengesë serioze dhe në atë kohë kjo donte të thoshte shumë. Paragjykimet fetare, opinionimi i ngurtësuar shoqëror, thashethemet si dhe niveli i ulët kulturor e bënë të pamundur bashkimin e këtyre dy të rinjve. Ndër kohë dashuria e tyre ishte e çiltër, e sinqertë, jetësore dhe ju jepte forcë të dy të rinjve për t'u ngritur mbi paragjykimet e mentalitetin prapanik që dominonte në qytetin tonë. Prandaj Selami një ditë e mori Donikën dhe e çoi tek shtëpia e dajos në lagjen "Cfakë", duke kryer kështu, si të thuash, një "rëmbim". Në këtë mënyrë triumfoi dashuria mbi meskinitetin, e reja mbi konceptet e vjetra patriakale dhe filloi kështu të ndërtohej një familje e re, e cila mbi 50 vjet do të jetonte në harmoni, dashuri, respekt e mirëkuptim midis


tyre dhe të respektuar e të nderuar nga opinioni Gjirokastrit.

Dashuria e respekti i Selamit për Donikën ishte e pakufishme dhe vitet e shumta që jetuan sëbashku në një harmoni të shkëlqyer familjare e materializon këtë. Ishte një respekt reciprok, një mirëkuptim e bashkëjetesë shembullore që të gjithë ne miqtë dhe shokët e tij bashkëlagjasit dhe opinioni qytetar e preknin çdo ditë. Dashuria e tyre zgjati rreth 2 vjet, deri në momentin kur Selami e "rërëmbu" Donikën.

Siç më tregonte vetë Selami kur unë e pyesja për krijimtarinë e tij të hershme, ai evidentonte edhe disa këngë që i kish kompozuar e që ja kushtonte Donikës dhe që i këndonte në rrethe të ngushta miqsh, larg syrit dhe veshit të opinionit. Një nga këto këngë ishte ndërtuar mbi poezinë e shkrimtarit të mirënjohur, "Mësuesit të Popullit", intelektualit të shquar dhe qytetarit të nderuar Bekim Harxhi dhe që titullohej "Ankohem nga një plep". Ja disa nga vargjet e këngës që më kujtohen tani:

Dritaren e gjithones  
Ky plepi ma ka zënë.....

Kështu mbas viteve të dashurisë së fshehur, në vitin 1956, Selami u martua me Donikën. Nuk vazhdoi shumë kohë mëria midis dy familjeve. Ajo filloi të zbutej gradualisht deri në normalitetin e plotë duke respektuar njera-tjetrën e duke ju dhënë bekimin fëmijëve të tyre. Selami ishte i respektuar e i dashur me të gjithë shokët, miqtë, kolegët, bashkëlagjasit e të gjithë ata që i njihte në qytet e në fshat, por njeriu që respektonte e donte mbi të tjerët ishte nëna e tij, ANEA siç i thoshte ai. Gjatë kohës që po shkruaja librin unë bisedova me gruan e tij Donikën, me vëllain Hulësinë, me djemtë, Fredin e Rudin e të gjithë më tregonin që Selami ishte i lidhur shumë



*Selami, Donika, Alfredi, Rudolfi.*

me Anenë. Ata të dy nuk ndaheshin dot nga njeri tjetri. Kur po pija kafe me Hulon, i kërkova të më sillte disa fotografi të Selamit n.q.se kishte në shtëpi për t'i vendosur në libër. Ai më tha se kishte shumë fotografi në shtëpinë e tij mbasi edhe kur Selami iku nga shtëpia për të jetuar në apartament, Aneja i tha se fotografitë do t'i mbante ajo, ashtu të vendosura në korniza në mure apo në albumet e shtëpisë. Është ky një fakt që tregon se Aneja e donte shumë

Selamin e kërkonte ta kishte gjithmonë para syve në shtëpi. Në bisedë me Hulon ai tregonte se Aneja interesohej shumë për Selamin dhe, kur të dy ishin të vegjël (Selami ishte 4 vjeç më i madh), ajo i thoshte Hulon se këtë bluzë, këmishë, pantallona apo këpucë etj. do t'i blejmë për Selamin se ai është më i madh e duhet të vishet mirë, se del në pjacë. Sa herë që dilnim nga pallati në përfundim të punës për të shkuar në shtëpi mbasi të dy banonim në lagjen "18 Shtatori" në pallate pranë njeri tjetrit, Selami do të kthehej një herë të shikonte Anenë, pastaj të shkonte tek shtëpia e tij. Ky ritual pothuaj ishte i përditshëm, bile edhe kur mbaronim ndonjë shfaqje estrade në mbrëmje, Selami do të ngjitej një herë të takonte Anenë, mbasandaj do të zbriste në shtëpinë e tij. Kjo tregon se ai ishte i lidhur shumë me nënën e tij dhe se e donin shumë njeri tjetrin, Selami ishte edhe një prind shembullor, ai e respektonte në çdo drejtim Donikën,

ai i donte shumë dhe interesohej për gjithshka edhe për dy djemtë e tij, Fredin dhe Rudin. Fredi ka lindur më 1959 dhe Rudi më 1964, Selami interesohej shumë dhe ishte i preokupuar për shkollimin e të dy djemve. Sa herë që takonte mësuesit e tyre, ai i pyeste për mbarëvajtjen e djemve në shkollë si në drejtim të sjelljes, ashtu edhe në përparimin në mësim. Të dy fëmijët e tij mbaruan me nota të mira gjimnazin "Asim Zeneli" të qytetit dhe, mbas shkollës së mesme, Fredi djali i madh vazhdoi studimet për arkitekturë në Universitetin shtetëror të Tiranës të cilin e mbaroi në vitin 1986.

Që nga ajo kohë, kur ai mbaroi studimet ka punuar në Gjirokastrë si inxhinier në sektorë të ndryshëm në administratë apo ndërmarrje. Fredi është i martuar dhe ka dy fëmijë. Ndërsa Rudi mbas gjimnazit vazhdoi një kurs për elektronikë dhe, mbas përfundimit të tij, punoi rreth 12 vjet si fonist në trupën e



*Festivali i V-të i Këngës në Gjirokastrë në vitin 1979.  
Dirigjent Naxhi Kasaraho, në firzamonikë Alfred Mamani*

estradës e të teatrit të qytetit. Në vitin 1989 unë kam qënë për dy vjet drejtor i Teatrit dhe kam ndjerë nga afër preokupimet, pasionin dhe merakun për punë që kishte Rudi. I gjithë kolektivi janë dëshimtarë për punën e mirë që ka bërë Rudi në këtë sektor të rëndësishëm për të rritur vlerat e shfaqjeve, gjë që fillonte nga sistemimi i materialeve me shumë merak dhe me kulturë në kabinën e tij teknike dhe deri tek cilësia mjaft e mirë e aparaturave të fonisë, ndonëse në atë kohë ishin të një teknologjie jo të përparuar. Edhe Rudi tani është i martuar dhe ka dy fëmijë. Të dy djemtë e Selamit u morën pak me muzikë. Fredi i binte fizarmonikës, të cilën e kishte mësuar nga Selami dhe në vitin 1979 mori pjesë në orkestrën e festivalit të 5-të të Këngës për të rritur, gjë që tregon pasionin e tij për muzikë Fredi e trashëgoi edhe tek vajza e tij Donisela e cila studion për piano. Rudi në vitin 1991, së bashku me disa shokë të tij si Nasi Goga, Tomi Rami, Igli Kokalari, e Ksenofon An-



*Alfred Mamani me fizarmonikë në Festivalin e vitit 1979.*

drea krijuan grupin muzikor "Meridian" ku dhanë rreth 10 shfaqje që u mirëpritën ngrohtësisht nga spektatori gjirokastrit. Ishte ky grupi i parë që krijohet mbas ndryshimeve të vitit 1990.

Selami ishte i lidhur shumë me të dy djemtë por gëzohej dhe i donte shumë edhe nipat e mbesat. Ai ishte shumë i lidhur me familjen dhe asnjë herë nuk largohet mbas dite, por gjithmonë do të dilte me Donikën për të bërë vizita tek njerzit e tyre apo tek miqtë e shokët. Ai ishte i lidhur shumë edhe me vëllain e tij, Hulon. Hulua, duke qënë më i vogli e respektonte shumë Selamin. Siç thotë ai, kur vinte Selami në shtëpi, unë çohesha në këmbë për të respektuar si vëllanë më të madh. Shumë i dashur Selami ishte edhe me motrën e tij, Vailenë. Ajo u martua rreth vitit 1965 dhe u largua nga Gjirokastra mbas martesës. Selami interesohet e i telefononte shpesh motrës. Ndërsa me babain, xha Fejzon, Selami kishte pothuaj mardhënie shoqërore, babai e konsideronte si shok Selamin, si djalin më të madh dhe çdo hall dhe problem që kishte në familje, xha Fejzua e konsultonte me të. Ndonëse në moshë të madhe Selami e ndjeu shumë vdekjen e babait në vitin 1968. Bile ka një fakt mjaft interesant kjo ngjarje. Në ditën kur i vdiq babai estrada profesioniste kishte një shfaqje premierë dhe prezenca e Selamit me firzamonikë, si drejtues i orkestrës, ishte e domosdoshme. Prandaj Selami si artist, duke respektuar dhe publikun, erdhi në shfaqje duke bërë një xhest të lartë qytetar dhe duke marrë vleftësimet maksimale të kolegëve dhe të spektatorit. Duke mbajtur një qëndrim të tillë Selami e rriti së tepërmi reputacionin dhe respektin në opinionin, duke treguar se me qëndrimin e një artisti ai respekton edhe traditat e zakonet por edhe skenën si tempull të artit. Kësaj ngjarje fatale e të trishtuar Selami ju përgjegj me ndjenjë të lartë qytetarie dhe me shpirt artistik.


Jeta private e Selamit është e mbushur me ngjarje e histori

nga më të ndryshmet. Në marrëdhëniet në familje, shoqëri, me kolegët dhe amatorët, bashkëlagjasit e qytetarët gjirokastritë etj, Selami do të ishte në qëndër dhe prezent humori aq i këndshëm e i pashterur, sjelljet e kulturuar, fjalët e urta e të çiltra e bënë atë një njeri me vlera e të konsiderueshëm. Nuk kishte ditë që Selami të mos krijonte situata humori sidomos me kolektivin e estradës me Ruston, Dhosin, Raqin, Etiminë, Nebon, Polon, Izetin, Maliqin, Xhinën, Mediun, Foton, etj, etj. Me taktin e tij, pa i fyer, por gjithmonë me dashuri, ju krijonte të gjithëve situata gazmore dhe e bënte të këndshme jetën në kolektiv. Deri në fund të jetës Selami do të karakterizohej nga një respekt e dashuri ndaj kolegëve e shokëve të tij, gjithmonë i qeshur e me humor, i cili nganjëherë prishte seriozitetin e ndonjë mbledhje. Bile me humorin dhe taktin e tij ai shpesh herë zgjidhte edhe situata të ndërlikuara që krijoheshin në sektorin e muzikës apo në trupën e estradës. Selami kaloi një jetë intesive artistike dhe



*Donika, Selami, Hulua.*





*Selami me Rudolfin, djalin e vogël.*



*Donisela duke luajtur në piano.*

gjithë jetës e u shtri edhe në mardhëniet tona familjare. Herë shkoja unë në shtëpinë e tij e herë vinte Selami tek unë.

Rreth vitit 1949 erdhën në Gjirokastrë për të kryer shërbimin ushtarak disa muzikantë nga Shkodra si Zef Leka, Preng Gjeloshi e Tonin Harapi. Ne me Selamin bashkëpunonim me këta muzikantë të talentuar dhe organizonin veprimtari të ndryshme artistike. Në Dhjetor të vitit 1955 u krijua estrada profesioniste dhe Selami hyri aty si fizarmoniçist në orkestrën e saj. Megjithatë bashkëpunimin tonë ne e vazhduam për çdo aktivitet që organizohej në shtëpinë e kulturës si dhe në shkollën “Pedagogjike”, ku unë isha arsimtar. Në vitin 1956 në Gjirokastrë vjen edhe kompozitorja e mirënjohur Dhora Leka. Selami ishte një bashkëpunëtor i afërt i saj dhe përfitoi shumë nga njohuritë dhe aftësitë e saj profesionale. Mbas vitit 1957 orkestra u zgjerua edhe me amatorë të tjerë nga qyteti. Në të rashmë bënë pjesë: Selam Mamani, Aleko Pano – në fizarmonikë, Tolo Njocko në trombon, Hajro Kokona – Trompë, Nasho Zhulla – Thodhori Kuvarati e Polo Xhori – në violinë, Naxhi Kasorhuo – në klarinetë, Niko Naka – në kondrabast e Vaso Naka në xhez. Gjithashtu aktivizoheshin edhe këngëtarët Rustem Asqeri, Xhina Papakosta, Saide Qofte, Koço Papaanastasi, Maliq Çomo, Xhina Titani etj. Njohja personale që kisha me Selamin shërbeu edhe për miqësinë midis familjeve tona. Nuk harroj mikëpritjen e Anesë (nënës së Selamit) që me buzë në gaz mundohej të më kënaqte e ç’nuk më vinte përpara për të ngrenë e për të pirë.

Selam Mamanin, kolegun e mikun tim më të shtrenjtë, e kujtoj me shumë respekt për kontributin e madh që ka dhënë në rritjen cilësore të muzikës në estradën profesioniste e krejt lëvizjen artistike të rrethit.

# NJERIU NUK VDES KUR VDES, POR KUR HARROHET.

NEBAHET SKËNDI  
(Aktore)

Shpesh ndjej trishtim. Shumë nga miqtë e mi të vjetër i ka rrëmbyer vdekja ose mërgimi. Më merr malli shpesh për ju, o miqtë e mi. Ju jeni pjesë e jetës sime. Selami, xhuxhi, siç të thoshnim në mardhëniet e ngushta. Njeriu që natyra zgjuarsinë, humorin, zhdërvjelltësinë ta kish dhënë pa kursim. Njeriu që dukej sikur kishte lindur me fizarmonikë mbi shpinë. Kështu zë vend në kujtesën, time qysh në vitet e herëshme të gjimnazit, kur hyje dhe zbrisje shkallët e shkollës, shkoje klasë më klasë për të zgjedhur elementin për aktivitetet e saj. Tingujt e fizarmonikës tënde trasmetonin ato melodi të mrekullueshme të këngëve Spanjolle, Franceze, të Amerikës Latine etj., po shfaqjet e mrekullueshme të estradës, ku spektatori nuk rreshtëte së duartrokitori dhe t'i mbeteshe në skenë gjatë gjithë shfaqjes me fizarmonikë në supe, sepse jo vetëm këngët, jo vetëm paroditë dhe kupletet, por edhe materialet letrare i shoqëroje me introduksione muzikore. Kur ti dilje nga skena shpatullat e tua ishin ujë në djersë. Sa herë bëje humor dhe thoshe: "Të gjithë i kanë kallot në duar ose në këmbë, unë i kam në shpatulla".

Aty ku ishte ti buronte humor. Aty ku ishte ti do të zgjidheshin problemet që do të lindnin. Ti në vetvete kishe shumë humor,



*Aktoret e estradës Nebehat Skëndi dhe Krisanthi Kallulli gjatë një shfaqje të vitit 1980*

diplomaci, aftësi organizimi, aftësinë për të dalë nga situatat e vështira, kishe sensin e masës për gjithçka. Akoma qesh me shpirt me ty dhe me Ruston, kur kujtoj kur u kthyem nga Labova në orën 12 të natës me një kamion të kooperativës dhe kishit marrë qingja për 1 Majin. Sa shumë kanë blegërirë ata qingja atë natë dhe ju të gjithë u lëshuat t'i mbyllnit gojën se tundën sheshin e "Çerçizit". Ishim në turne në zonën e Lunxhërisë, në fshatin "Labovë".

Të nesërmen do të ktheheshim se për 2-3 ditë vinte 1 Maji. Disa nga shokët blenë nga një qengj, por problemi ishte se si do t'i çonim në Gjirokastrë, sepse lëvizjet i bënim me korrierën e zonës. Biseduam dhe rregulluam me Kryetarin e kooperativës që të na çonte në Gjirokastrë, pas shfaqjes, kamioni i kooperativës. Kur po jepnim shfaqje dikush nga shokët qengjin e Rustos e kishte bërë vija vija të kuqe me makiazhet që kishim, kurse në ballë i kish sajuar një nishan të madh të kuq, sytë të rumbullakosura

me bojë qielli dhe buzët të kuqe. Kur erdhi koha që do të ngarkonim plaçkat në makinë dhe shokët shkuan të zgjidhnin qengjat, ne filluam të qeshnim me të madhe kur pamë qengjin e Rustos të lyer. Rustua u zemërua dhe filloi të bërtiste. U krijua një gjendje jo e këndshme dhe Selami ndërhyri që ta qetësonte atë, mbasi kur fliste, ai dinte të ndronte situatën, mbasi, siç i thonë fjalës, ai ishte melhemi në plagë. Po ç'ke ore i zi i tha Rustos. Këta njëlloj do të blegërijnë, si tëndi që është i lyer si timi i palyer. Nuk mendon ndonjë gjë si t'ja bëjmë kur të vemi në Gjirokastrë, se do të mbledhim qytetin e do të dëgjojë edhe shoku Ali (Ali Manaj), sekretari i parë i Partisë në rreth, e do të na pushojë nga puna.

Po tek Sofija, sa shumë qeshëm kur shkuam për të uruar për djalin që kishte lindur. Sofia ishte një grua aktiviste nga një fshat i Dropullit. Ajo ishte një grua shumë e mirë, e komunikueshme dhe e dashur. Duke vajtur shpesh në fshat ne kishim krijuar një lloj miqësie me të dhe ajo na merre në shtëpi për të pirë ndonjë kafe. Sofia në shtëpi kishte një kunatë të pa martuar, grua në moshë të mesme e cila nuk ishte fort e pashme, ishte e hollë, shumë e gjatë dhe shumë e zeshkët. Sa herë vinim tek Sofia Selami i thoshte me humor: Sofia, nuk trembe moj e zezë nga kunata se kjo është si lugat. Sofia qeshte dhe i thoshte se është shumë e mirë, Selam, le të duket ashtu. Një herë kur shkuam në fshat Sofia kishte lindur djalë dhe ne blemë një dhuratë dhe shkuam ta uronim. Në dhomën ku na pritën, ishte burri i saj dhe kunata e cila mbante fëmijën e porsalindur në duar. Sa shumë vendet të gjithë dhe u ulëm, Selami menjëherë i drejtohet kunatës së Sofisë: “trembet gjë djali”, “jo, i thotë ajo, nuk trembet, nganjëherë qesh”. Ne u shkulëm së qeshuri dhe nuk e mbanim dot gazin. Sofia që ishte nisur me tabaka në dorë për të qerasur u kthye nga rruga dhe nuk vinte dot në dhomë nga të qeshurit. Sa shumë kemi

qeshur me humorin tënd, sa herë i kemi kaluar situata ose gjendjet e vështira me humor, ose duke kënduar. Ishim në turne në zonën e Rrëzës së Dropullit, kishim 10 ditë që jepnim shfaqje nga 2 ose 3 në ditë. Ndërkohë nga Gjirokastra erdhi një urdhër që do të rrinim edhe disa ditë se ishte festa e kufirit. Kishim dhënë shfaqje në postën kufitare dhe mua më dhimbte këmba dhe çaloja kur ecnim rrugës nga fshati në fshat, sepse kur mbaronin shfaqjet në postë gjysëm orë e kishim mbrëmje dëfrimi sëbashku me kufitarët dhe ne femrat detyroheshim të vallzonim. Sa mbaronte shfaqja, vinim gjërat nëpër vende dhe Selami merrte fizarmonikën dhe fillonte meloditë, duke na i bërë me kokë të çoheshimtë merrnim ushtarët për vallëzim. Ne ishim 2 ose 3 femra të veshura nga këmbët me shapka nga ato të plazhit me një rip dhe rrugën nga fshati në fshat e bënim me këmbë. Kufitarët ishin malësorë, djem të gjatë të veshur me çizme. Kur vallzonin ata, ca që nuk lëviznin dot me ritmin e melodisë, ca nga emocionet dhe pa dashje na shkelnin këmbët. Atë ditë mua ma kishin shkelur këmbën. Ti gjatë rrugës më ngacmoje duke më thënë “moj Nebo, sa e kish numrin e këmbës ai kufitari”. Pas shfaqjes tek posta kufitare do të jepnim shfaqje në Brigadë dhe në darkë tek fshatarët. Unë ecja dhe ti herë pas here më thoshe: “sa e kishte numrin e këmbës ai kufitari”, deri sa më bëre për të qeshur.

Kur mbaruam dhe shfaqjen e Brigadës, u ngjitëm në fshat, hëngrëm një copë bukë dhe shkuam në vatrën e kulturës. Ishim të lagur, të lodhur, të mërëzitur, sepse turneu do të na zgjaste akoma. Sejcili rregulloi një vend për t’u shtrirë mbi ca gazeta të vjetra, mbi thasë, plaçka dhe perdet e shfaqjes. Kishim zënë vendet dikush në skenë, dikush në sallë, dikush mbi ndonjë tavolinë apo kish bashkuar dy karrige. Shiu vazhdonte të binte. Sejcili u shtri në vendin që kish përgatitur dhe u zhytëm në botën intime në atë gjëndje shpirtërore. Asnjë nuk fliste, ti

more fizarmonikën dhe fillove t'i bije një melodi, një kompozimi tënd të rinisë:

U kthyen zogjtë shtegëtarë  
Pranvera vjen e qeshur  
Pranverë moj pranverë  
Nuk qesh më zemra ime  
S'ka zemra zemrën pranë...

Ne secili në vendin e tij mëmërinim një nga një, u çuam të gjithë duke kënduar secili për vete, derisa u krijua një ansambël i mrekullueshëm. Kanë kaluar 32 vjet dhe emocionet e atij çasti më vinë të freskëta në mëndje. Ne të kujtojmë, Selam, në biseda me shokët, me miqtë, tregojmë histori për ty, të kujtojmë shpesh dhe, kur jam vetëm, sa e sa herë jam me ty o miku im dhe ndonjëherë më merr malli gjer në dhimbje. Kjo do të thotë se ti jeton, je brenda nesh, sepse njeriu nuk vdes kur vdes por kur harrohet.

# SELAM MAMANI NË KUJTESËN TIME

BERNARD KOKALARI

Regjisor

Jeta plot shqetësime dhe emocione në gjirin e një trupe artistike nuk mund të përballohet pa ndjerë ngrohtësinë shpirtërore të artistit, i cili është komponenti më i rëndësishëm në realizimin e një spektakli. Një nga këta artistë ishte dhe punë shumë e fjalë paku, Selam Mamani.

Për 30 vjet pranë njeri tjetrit, herë si bashkëlagjës e miq familjarë, herë si kolegë pune e herë si bashkëkrijues, kam ndjerë dhe ruaj të gjallë në kujtesën time portretin shpirtëror të Selamit në të cilin dalloje vetëm mirësi, ngrohtësi dhe urtësi. Këto karakteristika krijonin individualitetin njerëzor të Selamit duke e bërë atë një nga artistët më të dashur të kolektivit të estradës profesioniste.

Selami nuk ishte artist i fjalës artistike. Ai ishte artist i tingujve muzikorë, kjo e bënte që të fliste pak dhe të këndonte shumë. I shoqëruar gjithmonë nga shoqia e tij e ngushtë, fizarmonika, pa lënë pas dore kujdesin për gruan dhe fëmijët si dhe lulet dhe zoqtë e tij të dashur, ai, i mbyllur në kafazin e frymëzimit, mendonte, krijonte dhe kompozonte këngë, parodi dhe kuplete, afronte pranë vehtes këngëtarë amatorë e profesionistë. I kudo gjenduri Selam, nga skena e estradës në skenën e festivalit, nga skena e uzinës në atë të fabrikës, nga reparti ushtarak në grupin koral të shkollave e deri në kopështet e fëmijve, gjith-



monë e kurdoherë nuk shprehu shenja lodhjeje e mërzitje. Portreti i tij ishte gjithmonë i qeshur. Me humorin dhe buzëqeshjen e tij afronte pranë vehtes kolegët e tij të dashur Maliq, Rustem, Eftimi dhe Vitore, na afronte të gjithëve dhe na krijonte shlodhje edhe në ato momente kur puna nuk na shkonte mirë. Sa herë jam gjendur pranë Selamit e kam ndjerë vehten shunië të sigurtë. Ai ishte një koleg që nuk të linte kurrë në baltë. Kishte aftësi ngjitëse në shoqëri sikur të ishte nga mjalti. E kam ndjerë këtë cilësi të Selamit në kohën kur lëviznim nga fshati në fshat, apo rrethi në rreth për të dhënë shfaqje. Me Selamin më ka takuar të fle në një krevat, të ha në një pjatë. Më ka takuar të udhëtoj në shi e në vapë, ai me fisarmonikë në shpinë e neve me trasta në krah e bidona me vajguri në duar. Rrugët e ngushta e plot gurë e baltë të fshatrave na dukeshin bulevarde kur kishim Selamin pranë. Skena e Gjirokastrës ka parë shumë muzikantë, ka ndjerë tingujt e fisarmonikës së Aleko Karecos, Qimë Papallopullit, Sokrat Kalivopullit, Aleko Panos, Niko Nakës e Vaso Nakës, por ato tinguj që ju përkushtuan me jëtëgjatësinë më të madhe, ishin tingujt e fisarmonikës së Selam Mamanit, të cilat, sëbashku me emrin e tij, do të mbeten të gjalla në kujtesën dhe zemrën time.

# ME RESPEKT PËR KOLEGUN TIM SELAM MAMANI

JORGO ROZE  
Muzikant

Të shkruash për një koleg si Selam Mamanin, kolegu im i një jete të gjatë artistike mbi 30 – vjeçare në estradën profesioniste Gjirokastër, do të thotë të kesh parasysh një shembull të shkëlqyer



*Aktorja Raimonda Aleksi duke kënduar e shoqëruar nga orkestra nën drejtimin e Jorgo Rozës në vitin 1987*

të një njeriu të ndershëm e punëtor, të një drejtuesi e muzikanti që punoi me pasion gjithë jetën dhe që ka mbajtur një peshë në jetën e gjallë artistike të qytetit e rrethit tonë.

Selami në imagjinatën time mbetet një nga krijuesit model që lëvroi me merak dhe i shërbeu deri në momentet e fundit të jetës muzikës së popullit. Ai ishte një zgjedhës dhe seleksionues i pasionuar i motiveve folklorike të krahinave tona, përpunues e krijues i shumë këngëve që mbajnë gjallë tabanin kombëtar e në veçanti ngjyrën lokale. Është krijues i shumë këngëve të lehta për estradën profesioniste e qendrat e punës, i shumë potpurive popullore e krijimeve për fëmijë e deri tek kupletet e paroditë e



*Instrumentistë të orkestrës së Estradës në vitin 1987*

famshme të Selamit, i cili në çdo premierë, me nje ndjenjë të hollë prej mjeshtri e krijuesi, gërshetoi në mënyrë të shkëlqyer muzikën folklorike me atë popullore qytetare të qytetit tonë, sidomos muzikën humoristike e satirike të popullit, të cilës i shërbeu me pasion dhe e pruri në skenë me nivel artistik. Selami punonte me pasion me këngëtarët e parodistët, le të ishin ata profesionist e amatorë, ishte kokë ulur e të dëgjonte çdo vërejtje me zemërgjerësi, donte e kërkonte nivel të materialit muzikor, ishte dhe mbetet për kolegët e kolektivit të sektorit të muzikës dhe për punonjësit e estradës një nga njerëzit më me humor në jetën e përditëshme. Turnetë në qytete e në fshatra pa Selamin do të ishin pa variacion dhe nuk do të kalonin shkurtër; me humorin e Selamit ato kalonin pa u kuptuar e me shumë larmi. Selami kishte aftësinë të komunikonte me çdo shtresë e kategori njerëzish, ishte zemërgjerë e dinte të fálte. Më kujtohet para disa viteve patëm në sektorin e muzikës një debat pune disa orëshe, saqë ndonjë i jashtëm po të na dëgjonte do të thoshte: “Këta u prishën për jetë”. Pas mbledhjes ne u ulëm për të pirë një kafe me Selamin e me kolegët e kolektivit dhe Selami tha në konfidencë: “Bëjmë mirë që debatojmë e flasim për punën, sepse ajo na lidh e na bashkon në këtë institucion, ne mund të na mbetet qejfi e të zemërohemi, por punës nuk i duhet prishur qejfi”. Këto qenë fjalët që buruan me çiltërsi e sinqeritet nga zemra e tij dhe sektori vazhdoi punën normalisht, sikur të mos kish ndodhur asgjë.

Selami mbetet një nga krijuesit e instrumentistët që ka punuar më gjatë me estradën profesioniste të qytetit tonë, që nga krijimi i saj e deri pothuaj në rallimin e shuarjen e aktivitetit të estradës së Gjirokastrës. Ai ka dhënë një kontribut të çmuar si drejtues e instrumentist, si krijues e intelektual e si organizator. Selami mbetet një personalitet i estradës profesioniste të Gjirokastrës e sidomos i sektorit të muzikës. Të shkruash për


Selam Mamanin duhen faqe të tëra, por për mua, si pasues e vazhdues i punës në sektorin e muzikës në estradën e Gjirokastrës, ai do të mbetet një shembull i shkëlqyer i një njeriu të ndershëm e punëtor, gojëmjaltë e me humor, i thjeshtë e komunikues, që kërkonte nivel artistik, përparim, mirësi e drejtësi.

## KUJTIME E MBRESA NGA SHOQËRIA ME SELAM MAMANIN

DHOSI MARGARITI  
Aktor

Me Selamin jamë njohur thujse qysh para 50 vjetësh, qëkurse mirreshim me shfaqjet e grupeve amatore. Më tepër e forcuam shoqërinë kur punova sëbashku me të për 23 vjet në trupën e estradës profesioniste të Gjirokastrës. Veç punës së përbashkët që bënim në studjo e në skenë si gjatë provave dhe në shfaqje, me Selamin na lidhi dhe një shoqëri personale; ishte njeri i komunikueshëm, dinte të sillej me njerëzit sipas moshës, punës e intelektit të sejcilit. Ne me të diskutonim jo vetëm problemet e punës, por edhe për problemet e hallet tona personale, këshilloheshim me njeri tjetrin, si i thonë mernim e jepnim mendje.

Selami ishte shumë i lidhur me punën. Në çdo premierët të re, Selami do të bënte pa tjetër një këngë të re e, sidomos, ato me motive popullore të jugut, punonte deri sa të arrinte cilësinë artistike çdo ditë deri vonë e gjeje në studio duke punuar, vetëm ose me shokët e sektorit të muzikës dhe me këngëtarë që bënin prova.



*Aktorët Dhosi Margariti dhe Ruzhdi  
Lluri në vitin 1981*

Kur dilnim turne të gjata me shkëputje nëpër fshatra nga 15-20 ditë, Selami ishte njeriu që na krijonte atmosferën gazmore për të kaluar mërzitjet e ditëve të gjata, e sidomos për shoqet tona që e kishin mendjen tek fëmija e tek shtëpia që i mungonte nikoqirja për 15 ditë. Jo vetëm në turnet e fshatit, por edhe në shumë raste kur shkonim në turne jashtë rrethit në qytete të tjera, që sipas rregullit duhej një përgjegjës, të gjithë ishin dakort që të vinim Selamin. Ishte i komunikue-

shëm me njerëzit e pushtetarët e fshatit, i rregullonte gjërat si jo më mirë, se ishte problem për të siguruar ushqimin e fjetjen e trupës, transportimin e materialeve nga një fshat në tjetrin, e të tjera probleme të natyrës së punës. I thoshim: “dy pëllëmbë je, mor i zi, dhe me fjalët e tua e piks ujin e bën kos, grurë e ke muhabetin me të tërë, por sikur të ishte dhe ca më i gjatë, kushedi çfarë do bëje” e ai thoshte i kënaqur “po ja që s’jam, se po të isha, do të siguroja helikopterin të vinim në darkë në shtëpi e të nesërmen të vinim prapë të japim shfaqjen”. Selami dallohej për humorin e tij, por më tepër shakatë i bënte me shokun tonë Ruston, bile edhe në raste kur humori nuk bëhej.

Mbaj mend kur i vdiq babai Rustos, e ne si kolektiv shkuam të gjithë për ngushëllim. Në atë kohë Rustemi ishte 50 vjeç dhe në momentin që e ngushëlloi dhe e përqafoi, Selami i thotë: "... Mbi të gjitha më vjen shumë keq se të la edhe të vogël, por s'ke ç'i bën gajret". Në atë moment jo ne por edhe vetë Rustemit i vinte për të qeshur. Mua, gjatë roleve të ndryshme që më jepte regjisori, në shumë raste më takonte të merja pjesë dhe në ndonjë parodi masive e sidomos me motive këngë popullore, por e kisha pak të vështirë të hyja në kohë, dhe Selami më thoshte, mos kij merak, mos e vra mendjen, shikom mua në sy, kur unë të ul sytë ti fillo se në rregull je dhe vazhdo se të ndjek unë me fizarmonikë." Në problemet artistike nuk i linte në baltë dinte të dilte nga situata. Selami ishte korekt në orar të punës, do vinte ose para fillimit të shfaqjes për të bërë përgatitjet e nevojshme, shqetësohej edhe jepte mendime edhe për probleme të ndryshme që punët të shkonin sa më mirë në gjithë institucionin. Kam edhe një kujtim që mund të them se është i fundit nga shoqëria me Selamin e shokët e punës. Kur dola në pension, në fund të vitit 1990, u thashë shokëve: punova 23 vjet, kaluam shumë mirë, ika i gëzuar nga teatri, prandaj do bëj një darkë, por do vini të gjithë kështu si jemi komplet estrada. Dhe kështu u bë, ishim 50 veta sipas mundësive të kohës u përpoqa t'i kënaqja shokët dhe vërtet u kënaqën. Më thotë në vesh Selami: "Po ti more e ke bërë si dasëm, bërë goxha shpenzime, kurse ne vumë nga 100 lek të vjetra (se aq qe në atë kohë). I them më vjen keq, unë i mora parasysh, mjafton që ju erdhët më nderuat dhe u kënaqët, pa zëre se bëra dasëm se unë kur u martova s'bëra dasëm". Pas pak u krijua një pauzë qetësie ngrihet Selami me gotën e birrës në dorë dhe u thotë shokëve dhe shoqeve: "Këtë shëndet do ta pimë për çiftin të na trashëgohen". Ata panë njeri-tjetrin në sy po ky u deh ç'thotë, ndërhyh prapë mos u çudisni ju thotë, do ta pimë

për çiftin Dhosi e Kato, se këta sot martohen, se kur u martuan vërtet s'kanë bërë dasëm dhe s'i ka uruar njeri e shpërtheu gazi e shakatë.

E kishim shok të mirë, por u nda shpejt nga jeta e nga shokët, së bashku me shokët e tjerë të estradës që për disa vjet ikën shumë si Polua, Rustua, Dhimua, Izeti, Maliqi, Baftiari. Kaluan vite por në kujtesën tonë Selami dhe shokët e tjerë do mbeten për herë pranë. Ne shokët e vjetër, kur takohemi me njeri-tjetrin, fillojmë nga muhabeti e kujtimet dhe humorin e Selamit e kujtojmë me nostalgji dhe na duket sikur i kemi pranë e do bisedojmë me ta.

## BURRI SHTATSHKURTËR QË DO TË KUJTOHET GJATË

RAQ PASKAL  
(Udhëheqës Artistik i Cirkut)

Po shkruaj pak fjalë dhe shumë nderime. Ndonëse pa arsim profesional, arriti ta njihnte mirë muzikën popullore, potpuritë Gjirokastrite, Vlonjate dhe intonacionet e labërisë që kap zonën e Gjirokastrës. Ka ditur të drejtojë përkohësisht muzikën në pallatin e kulturës, shef i saj kryesor. Në estradë ka qënë krahu i djathtë i Jorgo Rozes. Me atë fizarmonikën në duar e parafytyroj gjithmonë. Si njeri e njihja mirë. Ishte i afrueshëm, komunikues, i sjellshëm dhe vishej mirë edhe pse mbante mirë familjen. Edukoi dy djem të mirë, të dashur e buzagaz si di ai vetë. Kur unë krijoja ndonjë këngë apo pjesë muzikore, ja fërshëlleja ose ja luaja me



kitarë dhe ai menjëherë ma hidhte në pentagram. Si mjeshtër i cirkut, unë punova 15 vjet profesionist së bashku me të në estradë. Plus 15 vjet të tjera kur ishim amatorë në pallatin e kulturës dhe të pionierit. Në çdo telash Selami gjente mënyrën për të lehtësuar shokët e pleksur keq me drejtorin apo organizatën bazë të partisë. Gjatë turneve që estrada, cirku dhe muzika bënte në të gjithë Republikën, ai rinte pranë meje dhe unë pranë tij. Që nga Saranda, Berati, Tirana, Shkodra e gjer në Bulqizë e Kukës. Veçanërisht kur hanim drekën apo darkën, bashkonim 2 ose më shumë tavolina dhe mua nuk më zihej ushqimi po të mos kisha pranë ose përballë Selamin ose Jorgo Rozen, disa akrobatë apo ndonjë shoqe si Nebahet Skëndi, Merjeme Mevlani, Eftimi Llambro etj. Kënaqësia e tij më e madhe ishte kur i thosha: “Selam, mos e pi cigaren se do të të qeras me një dopjo raki çdo ditë” Cigari e sëmuri atë si njeri, ky është mendimi im si doktor. Selami dhe fizarmonika janë sinonime, ai burrë i shkurtër do të kujtohet gjatë”.

## EMRI I SELAM MAMANIT DO TË NGELET I PËRVEÇËM PËR TË GJITHË

OSMAN ESAT BUZO

Regjisor i Teatrit të fëmijëve

Jeta është një film, dhe ne njerzit jemi personazhet e këtij filmi, fillimi i të cilit nuk dihet dhe fundi i tij nuk mund të imagjinohet. Një nga këta personazhe është dhe miku im i paharruar, muzikanti me emër Selam Mamani.



*Regjisori Osman Buzo me trupën e teatrit të kukullave.*

Ai del nga filmi i jetës, krejt pa pritur, si një kapricio e të madhit dhe unë, miku i tij, sot kthej vështrimin pas për të parë gjurmët që la ky meteor në qiellin gri të qytetit të Gjirokastrës. Rastësia që është mbreti i botës, e përplas varkën time të jetës në këtë qytet kështjellë aty nga vitet 70 të këtij shekulli, dhe Selami ishte një nga kështjellarët që dorën e ngrohtë të mirseardhjes. Ai ishte i kudo gjendur, pa grada e ofiqe, por pa pëlqimin e tij nuk ndiheshe ngrohtë në rrethet artistike. Përvoja i kishte dhënë një pushtet prej plebeu, dhe kur u paraqita në publikun e Gjirokastrës si aktor e recitues, ky njeri ishte nga të parët që më uroi. I qeshur e hokatar, ai ishte njeriu më serioz në punën e tij dhe personazhi më i spikatur, në Estradën e Gjirokastrës, firzamicisti më me emër në jugun e Shqipërisë. Kur të gjithë, u mbaroheshin forcat nga puna ndonjëherë rutinë, ai u shkonte punëve gjer në fund, duke elektrizuar dhe të tjerët. Mjeshtri i madh, u bë bashkëudhëtari im në fushën e teatrit

të fëmijve, ku unë u caktova, kalorës i parë, në vitet 1970. Selam Mamani dhe aradha e muzikantëve brilante si Jorgo Roze, Roland Çene, e më të rinjtë Saimir Skënduli, Jani Kaçi, Haxhi Selfo, dhe Petro Minxha e Naxhi Kasoruh, të gjithë kontibuan dhe ishin prezentë në spektaklet e teatrit të kukullave me krijimet e tyre muzikore që shijoheshin e brohoriteshin nga mijëra fëmijë, në tërë Shqipërinë; 100 premiera, 50000 shfaqje. Dhe përsëri Selami ishte si ai varkari i lashtë; mbi të përplaseshin gjithë dallgët muzikore të Shqipërisë së jugut, orkestrina, furtunë festivalesh, dallgë folklorike, dhe kudo ishte në skalionin e parë, me fizarmonikën e tij, i qeshur, Selam Mamani. Kurrë nuk mendoj se ai mungon. Ai është mes nesh. Këto vite kur shqiptarët lakmuan t'i hipnin TITANIKUT dhe të rrezikonin në detrat e pa njohura, Selami, unë dhe shumë të tjerë u dhamë zemër njerëzve, për të mos i braktisur këto brigje, më të majmet e kësaj bote, dhe këtë e bëmë duke qëndruar këtu.

Selami më vinte shpesh në treg, ku unë mësoja ekonominë e tregut dhe flisnim gjatë për këtë jetë kaq të shkurtër... Gjithë këto relata të miat si regjisor, me muzikën dhe muzikantët, e dhanë frutin e tyre: Doriani, më i bukuri i fëmijve të mi, u bë trompist, borizani që mësoi gjithë këngët e zogjve, që në moshën 16 vjeç u bë trompë e parë në festivalin e fëmijve që shiti i pari muzikë me kaseta në tregun e Gjirokastrës. Në vitin 1992 u nda nga jeta në moshën të re duke na lënë të shokuar dhe me misjonin human që t'ju shërbejmë këngë dhe gaz gjithë kalimtarëve pranë kësaj kështjelle të lashtë, të bëhemi si një zjarr Olimpik notash pa mbarim, nota të gëzuara të njerëzve të vuajtur, që e shkrinë jetën për të siguruar të ardhmen e atyre që vijnë pas, të karvaneve pa mbarim... Për këtë punoi edhe Selam Mamani, miku im, që meriton shumë e shumë lavde njerëzore dhe në panteonin e këtij qyteti, ky emër do të ngelet i përveçëm.







*Selami me Donikën, djemtë, nusët dhe mbesat.*




*Selami me vëllain Hulon dhe bashkëshortet.*



*Selami me djalën e madh Fredin.*



*Selami me Donikën dhe mbesat.*



*Selami me QimoPapallopullin, shokun e rinisë.*

## EPILOGU

Kaluan rreth 5 vjet nga dita kur Selam Mamani, miku i dashur, shoku, bashkëpunëtori ynë artistik, u nda nga jeta duke lënë në pikëllim të thellë gruan, djemtë, të afërmit edhe ne. Autoriteti që formoi si muzikant me krijimtarinë e tij të bollshme e me vlerë, si dhe mardhëniet e shkëlqyera që kishte me komunitetin artistik e bëjnë që ai të jetë prezent gjithmonë në të gjitha bisedat dhe aktivitetet tona me kujtimin e mirë të veprës së vyer që la pas. Siç shprehet një kolegia e tij se: “Njeriu nuk vdes kur vdes, por kur harrohet”, dhe Selam Mamani do të ngelet i tillë gjithmonë prezent i përherëshëm dhe i vlerësuar nga të gjithë. Me fizarmonikë në krah nga fillimi i viteve 50 e deri në 1996, kur u nda nga jeta, Selami do ngelet simbol i njeriut të punës, të krijimtarisë së bollshme, të shokut e mikut të mirë që me humorin e hollë e inteligjent do të bashkonte rreth vetes aq amatorë e dashamirës të artit, duke u bërë krijuesi më i respektuar nga mbarë opinioni. Në këto vitet e fundit të këtij tranzicioni të egër e ndjeja mungesën e Selam Mamanit, pra më mungonte humori, optimizmi, kurajua e tij, të cilat, pasi bindesha se nuk i kisha, zhytesha në pesimizmin e ditëve të rëndomta që pasonin. Një shkatërrim total i institucioneve artistike – mbyllja e shkollës së muzikës - një vakum i krejt lëvizjes artistike dhe shtegëtimi galopant masiv i gjithë krijuesve të qytetit, më detyruan t’i thërras ndërgjegjes qytetare e artistike dhe së paku të bëj prezent e të evidentoj këto vlera të mohuara e kaq madhore për kohën që kaloi si dhe këta njerëz që i mbartën e krijuan ato.




Monografi, për Selam Mamanin pasqyron qartë e gjerësisht këto vlera e këtë kontribut të artistëve në Gjirokastrë dhe plotëson sado pak dhe njëkohësisht bën apel për të gjithë ne që të japim kontributin dhe angazhimin tonë intelektual dhe artistik, që jo vetëm këto vlera të njihen e të respektohen, por nëpërmjet veprimtarive kulturore artistike të gjallërojnë jetën intelektuale të përgjumur të qytetit tonë të dashur e shumë të bukur.

Autori  
Gjirokastrë Shtator 2001

## PËRMBAJTJA

“Fizarmonika” .....	11
Estrada profesioniste, Trupa artistike që dha kontribut në gjallërimin e jetës artistike te qytetit .....	16
Krijimtaria .....	44
Jeta private .....	59
Opinione – mbresa – kujtime – vlerësime – për Selam Mamanin	
nga miqtë e kolegët .....	69
Njeriu nuk vdes kur vdes, por kur harrohet. ....	71
Selam Mamani në kujtesën time .....	76
Me respekt për kolegun tim Selam Mamani .....	78
Kujtime e mbresa nga shoqëria me Selam Mamanin .....	81
Burri shtatshkurtër që do të kujtohet gjatë .....	84
Emri i Selam Mamanit do të ngelet i përveçëm për të gjithë .....	85
EPILOGU .....	92



*Ka lindur më 22 dhjetor 1941 në Gjirokastrë. Ka mbaruar studimet për muzikë në Liceun Artistik "Jordan Misja" dhe Konservatorin Shtetëror të Tiranës.*

*Ka një veprimtari të gjërë artistike si klarinetist-kompozitor-organizator-muzikolog. Është autori i 4 Metodave për Klarinetë; i librit "Gjirokastra e Festivalit"; i shumë këngëve dhe drejtues i grupeve popullore të rrethit në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës.*

*Është dekoruar me Urdhërin "Naim Frashëri" i Artë.*

**NAXHI KASORUHO: Selam Mamani - Një jetë me këngë**

ISBN: 99927-51-02-9, albin, Tiranë 2002. Çmimi 300 lekë